



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 212 Akti

Nr. 273 Vendimi  
Tiranë, më 10.7.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	Kryesuese
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Relatore
<b>Firdes Shuli</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datat 9.1.2020, ora 13:00 dhe 7.7.2020, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Alkelina Z. Gazidedja**, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE :** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, shqyrtoi dhe analizoi çështjen duke u bazuar në të tria kriteret e vlerësimit, atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5, të nenit 179/b, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5, të nenit 3, dhe në pikën 1, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.
3. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, i është nënshtuar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur në datën 15.11.2018 në përputhje me “Rregullore për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.
4. Në referim të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit ka filluar menjëherë, pasi janë caktuar me short trupat gjykues të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe është shortuar shpërndarja e çështjes konkrete.
5. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 21.11.2018 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga dy anëtarët e trupit gjykues, ndërsa një prej tyre deklaroi konflikt interesi, si dhe paraqiti dorëheqjen. Kjo dorëheqje u shqyrtua nga një trup tjetër gjykues i zgjedhur me short, i cili, me vendimin e datës 22.11.2018 ka vendosur pranimin e kërkesës për dorëheqje. Anëtari i trupit gjykues i dorëhequr zëvendësohet nga komisioneri zëvendësues, i zgjedhur me shortin e datës 15.11.2018. Me kërkesën e datës 27.11.2018, anëtari zëvendësues dha dorëheqjen për shkak të konfliktit të interesit. Kjo kërkesë u shqyrtua nga një trup tjetër gjykues, që me vendimin e datës 5.12.2018 ka pranuar kërkesën. Me shortin e datës 11.12.2018 u caktua anëtar i trupit gjykues komisionere Firdes Shuli, e cila deklaroi menjëherë mospasjen e konfliktit të interesit.
6. Në referim të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.
8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës.
9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislationin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

10. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

11. Në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishtëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- **deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,**
- **ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë;**
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- **subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.**

12. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.

13. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishtëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

14. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

15. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 19.11.2019, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, njoftimin për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

16. Po në të njëjtën datë, subjekti u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni brenda datës 2.12.2019. Subjekti, pasi u njoh me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni në datën 25.11.2019, kërkoj: (i) të pranohet si provë, këqyrja në vend e shtëpisë së banimit. Kjo kërkesë, me shumicë votash, është rrëzuar nga Komisioni me vendim nr. \*\*\*, datë 25.11.2019, me arsyetimin se këqyrja e objektit është e panevojshme për zbulimin e së vërtetës, sipas parashikimeve të nenit 49/7 të ligjit nr. 84/2016. Njoftimi i subjektit për refuzimin e kërkesës është bërë me anë të *emal*-it të datës 25.11.2019,

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim nr. \*\*\*, datë 11.9.2019, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2019.

ndërsa vendimi i arsyetuar i është dërguar në datën 27.11.2019; (ii) kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në raport me barrën e provës. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit, e gjykoi atë të arsyeshme duke e shtyrë afatin e shpjegimeve në datën 10.12.2019.

**17.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

**18.** Në datën 9.1.2020, datë në të cilën u zhvillua seanca dëgjimore, në Komision u administrua një denoncim anonim, i protokolluar me nr. \*\*\* prot. Menjëherë me administrimin e këtij denoncimi, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit për të dhënat e parashtruara.

**19.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datën 13.1.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, njoftimin për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit shtesë, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Po në të njëjtën datë, subjekti u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni brenda datës 20.1.2020. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën e përcaktuar nga Komisioni.

**20.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar në datën 22.1.2020 në kuadër të një hetimi të plotë dhe të thellë për garantimin e një procesi të rregullt ligjor, konsideroi të nevojshme administrimin e dosjeve të plota gjyqësore që i përkasin vendimeve nr. \*\*\*, datë 6.7.2016 dhe nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Lartë duke vendosur riçeljen e hetimit administrativ.

**21.** Pas riçeljes së hetimit administrativ, trupi gjykues, vendosi të administrojë dosjet gjyqësore të vendimeve të mësipërme.

**22.** Trupi gjykues, në përfundim të hetimit shtesë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes në datë 9.6.2020, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, njoftimin për t`u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit shtesë, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative. Po në të njëjtën datë, subjekti u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni brenda datës 25.6.2020. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në datën e përcaktuar nga Komisioni.

**23.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**24.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancat dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht.

**25.** Seancat dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvilluan në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datat 9.1.2020, ora 13:00, dhe 7.7.2020, ora 9:30, në Pallatin e Kongreseve, salla B, kati 0 (*underground*), në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma.

**26.** Në të dyja seancat, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojti personalisht, duke shprehur opinionin e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.

27. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

### III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

28. Znj. Alkelina Gazidedja ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ dhe ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

### IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

29. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

30. Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, nr. 2/2017<sup>4</sup> dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

31. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar -Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) “Deklaratën e Rivlerësimit Kalimtar -Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI;
- ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision;
- d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016;
- dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komisioni nga KLGJ-ja;
- ë) denoncimet e publikut; dhe

---

<sup>4</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtar”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit, apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**32.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 30.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**33. Dyqan<sup>5</sup>, me sip. 25.7 m<sup>2</sup>, njësia nr. \*\*\*, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, me vlerë 5,474,100 lekë dhe me pjesë takuese 50 %.**

**33.1 Burimi i deklaruar i krijimit:** (i) blerë nga të ardhurat e familjes të ndodhura depozita në bankë (të krijuara nga paga, qiratë dhe shitja e makinave); dhe (ii) hua e marrë nga motra e bashkëshortit, znj. B. G. M., në vlerën 1,800,000 lekë, kaluar 1,650,000 lekë në llogarinë e deklaruësës, në po atë datë, në “ProCredit Bank”, ndërsa 150,000 lekë jashtë banke, hua e cila është shlyer në vitin 2013 nëpërmjet “ProCredit Bank” (sipas mandatpagesave).

### **Hetimi<sup>6</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri**

**33.2** Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit në datën 30.4.2012 me kontratë nr. \*\*\*, ka blerë nga shtetasi L. H., njësi me sip. 25.7 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, me adresë: Godina \*\*\*-katëshe, Rr. “\*\*\*\*”.

**33.3** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se pagesa e këtij dyqani është bërë nëpërmjet sistemit bankar, me një këst, në datën 30.4.2012, nga ku rezulton se nga llogaria e subjektit të rivlerësimit në “ProCredit Bank” është transferuar shuma prej 5,474,100 lekësh, te llogaria e shitësit të njësisë.

**33.4** Si burim për blerjen e këtij dyqani subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: (i) të ardhurat e familjes të ndodhura depozita në bankë (të krijuara nga paga, qiratë dhe shitja e makinave); si dhe (ii) hua e marrë nga motra e bashkëshortit, znj. B. G. M., në vlerën 1,800,000 lekë.

## **Hetimi/analiza ligjore-financiare për burimin e krijimit të pasurisë**

---

<sup>5</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. \*\*\*, datë 30.4.2012; (ii) vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 4.5.2012, në emër të z. D. G., + hartë treguese, për dyqanin me sip. 25.70 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; (iii) vërtetim hipotekor nr. \*\*\*, datë 27.4.2012, në emër të shitësit L. H., + hartë treguese për dyqanin me sip. 25.70 m<sup>2</sup> + kartë ID; (iv) kartela e pasurisë për dyqanin me sip. 25.70 m<sup>2</sup>, në emër të z. D. G., me shumë të paguar 5.474.100 lekë + hartë treguese; (v) nxjerrje llogarie “ProCredit Bank”, datë 18.2.2013, ku vërteton se z. D. G., i ka kaluar znj. B. M., shumën prej 1.500.000 lekësh, për shlyerje detyrimi + mandat “ProCredit Bank”; (vi) mandatarkëtimi “ProCredit Bank” datë 31.5.2013; (vii) mandatarkëtimi “ProCredit Bank”, datë 28.3.2013; (viii) mandatarkëtimi “ProCredit Bank”, datë 30.4.2012; (ix) aplikim për regjistrim pasurie të paluajtshme; (x) mandat “Credins Bank”, datë 26.1.2017.

<sup>6</sup> (i) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Zyrës Qendrore Të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; (ii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar OSHEE-së; (iv) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë; (v) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2019, drejtuar OSHEE-së.

**33.5** Në lidhje me burimin e të ardhurave të familjes të ndodhura në depozita nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

**33.5.1** Nga lëvizjet e llogarisë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit në “ProCredit Bank”, rezultojnë të jenë kryer veprimet e mëposhtme:

- i. Subjekti i rivlerësimit në datën 30.4.2012, ka transferuar shumën prej 1,350,000 lekësh nga llogaria e kursimit, të krijuar ndër vite me të ardhurat nga paga e subjektit, te llogaria rrjedhëse, po në emër të saj.
- ii. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, në të njëjtën datë 30.4.2012, ka transferuar nga llogaria/depozitë e tij shumën prej 2,501,875 lekësh te llogaria e subjektit.

Nga hetimi ka rezultuar se depozita e bashkëshortit të subjektit në shumën prej 2,501,875 lekësh, e ka burimin nga bashkimi i dy depozitave të çelura prej tij në “ProCredit Bank”, si më poshtë:

**33.5.1.1** Në datën 27.1.2010 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka çelur depozitë bankare në “ProCredit Bank” duke depozituar, *cash*, shumën prej 1,000,000 lekësh.

Kjo shumë, bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në DVP-në e vitit 2010, si dhe gjatë hetimit administrativ, e ka burimin nga llogaria e bashkëshortit në “Tirana Bank”.

Në datën 16.6.2010, kësaj depozite i shtohet shuma 500,500 lekë e depozituar *cash*. Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për të krijuar këtë shumë.

	16.6.2010
<b>Të ardhurat</b>	<b>1 022 166</b>
D. G.	570 505
Alkelina Gazidedja	451 660
<b>Shpenzimet</b>	<b>250 470</b>
<b>Likuiditet krijuar deri më 30.10.2010</b>	<b>600 500</b>
Subjekti i rivlerësimit, <i>cash</i> në “ProCredit Bank”, më 19.1.2010	100 000
Bashkëshorti, <i>cash</i> , në “ProCredit Bank”, më 16.6.2010	500 500
<b>Teprica të mundshme për kursim</b>	<b>171 196</b>

**33.5.1.1.1** Në lidhje me burimin e shumës prej 1,000,000 lekësh (e cila ka shërbyer si burim për krijimin e depozitës në datën 27.1.2010), nga hetimi administrativ ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 1,281,000 lekë nga “Tirana Bank”. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash* për vitin 2009, ndërkohë që në DPV-në e vitit 2010 në lidhje me hapjen e depozitës në “ProCredit Bank” subjekti ka deklaruar se: “*U mbyll depozita në ‘Tirana Bank’ dhe u hap në ‘ProCredit Bank’*”.

**33.5.1.1.2** Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje *cash* në vitin 2009, shuma prej 1,218,000 lekësh nuk është përfshirë si burim për krijimin e depozitës në datën 27.1.2010, duke i kaluar subjektit barrën e provës për mungesë të ardhurash për hapjen e depozitës në vitin 2010, në shumën 1,000,000 lekë, në “ProCredit Bank”.

**33.5.1.2** Në datën 27.5.2011 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar *cash* shumën 1,000,000 lekë në “ProCredit Bank”, duke çelur një tjetër depozitë me afat.

Në lidhje me burimin e shumës prej 1,000,000 lekësh në përgjigje të pyetësorit të parë subjekti ka sqaruar se si burim kanë shërbyer dy tërheqje të bashkëshortit të saj në BKT, përkatësisht në datën 6.5.2011, ku është tërhequr shuma 500,000 lekë dhe në datën 19.5.2011, është tërhequr shuma 562,250 lekë. Këto tërheqje konfirmohen edhe nga nxjerrjet e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në BKT. Burimi i këtyre shumave është depozitimi i pagës së

bashkëshortit të subjektit në datë 5.04.2011 nga punëdhënsi \*\*\* në shumën 1,062,256 lekë në llogarinë e tij BKT. Nga analiza financiare (në lekë) në tabelën më poshtë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës prej 1,062,250 lekësh.

	<b>2011</b>
<b>PASURI</b>	<b>610 450</b>
<i>Shtesa/Pakësime/Likuiditete</i>	<i>610 450</i>
Likuiditete gjendje	4 418 279
<b>TË ARDHURA/dokumentuar</b>	<b>3 451 175</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	989 389
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 788 828
Interesa nga bankat	272 958
Të ardhura nga qiraja e banesës	400 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 353 824</b>
Shpenzime jetese	546 480
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	97 073
Shpenzime mobilimi (sipas P. 2)	210 000
shpenzime për legalizim të ndërtesës 3K	4 900
Shpenzime doganore për automjetet	280 121
Shpenzime shkollimi	153 000
Shpenzime të tjera (të evidentuara)	62 250
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>1 486 901</b>

**33.5.1.3** Në datat 27.11.2011 dhe 30.11.2011 janë maturuar të dy depozitat e mësipërme duke krijuar shumën prej 2,521,000 lekësh.

### **33.5.2 Në lidhje me huan, në shumën 1,800,000 lekë, marrë znj. B. M.**

**33.5.2.1** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se znj. B. M., në datën 30.4.2012 ka transferuar shumën prej 1,650,000 lekësh nga llogaria e saj në “ProCredit Bank” në llogarinë e subjektit të rivlerësimit në po të njëjtën bank.

**33.5.2.2** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se origjina e shumës 1,650,000 lekë është një depozitë e kryer në datën 12.2.2009, në shumën 1,550,000 lekë , nga znj. B. M., në “ProCredit Bank” me përshkrimin “të ardhura familjare”. Është pikërisht kjo shumë që më pas i është transferuar subjektit të rivlerësimit.

**33.5.2.3** Në tabelën më poshtë pasqyrohet analiza financiare në lidhje me aftësinë e znj. B. M., për krijimin e depozitës në datën 12.2.2009.

Komisioni në përgatitjen e analizës ka mbajtur në konsideratë faktin se znj. B. M., nuk është subjekt i deklaramit të pasurisë, për rrjedhojë, në analizë është përdorur metoda kumulative, si më poshtë:

- Periudha e analizuar nga momenti i fillimit të punës së znj. B. M., deri në krijimin e depozitës në shumën prej 1,550,000 lekësh në datën 12.2.2009, e cila është zanafilla për huan e dhënë në vitin 2012.



- Deri në datën 4.12.2006<sup>7</sup> znj. B. M., është analizuar vetëm (të ardhura, shpenzime, likuiditete, etj.) dhe pas kësaj date në analizë është përfshirë edhe z. I. M., me të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e tij.

<i>Huadhënësja</i>	2003	2004	2005	<i>1.1 deri 4.12.2006</i>	<i>4/12 deri 31.12.2006</i>	2 006	2 007	2 008	<i>12.2.2009</i>	<b>Total</b>
Të ardhura	291 412	469 572	703 997	879 841	124 413	1 004 254	1 467 805	1 587 629	189 747	5 714 416
Shpenzime	93 964	93 964	109 557	100 427	43 260	143 687	618 780	687 860	98 285	1 846 097
<i>Ndryshim likuiditetesh</i>	<i>40 517</i>	<i>531 993</i>	<i>-193 516</i>	<i>3 921</i>	<i>73 524</i>	<i>77 445</i>	<i>509 945</i>	<i>1 328 249</i>	<i>1 567 235</i>	<i>3 861 868</i>
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>156 931</b>	<b>-156 385</b>	<b>787 95</b>	<b>775 493</b>	<b>7 630</b>	<b>783 123</b>	<b>339 080</b>	<b>-428 480</b>	<b>-1 475 773</b>	<b>6 451</b>

**33.5.2.4** Komisioni ka bërë edhe një analizë për mundësinë financiare të znj. B. M., në datën e dhënies së huas.

	<b>2003 – 30.4.2012</b>
<b>Të ardhura</b>	<b>12 068 875</b>
Paga e B. M.	8 229 175
Paga e I. M.	2 512 650
Interesat e bankës	1 227 050
Kredia marrë më 18.11.2009	100 000
<b>Shpenzime</b>	<b>4 423 641</b>
Shpenzimet e jetesës	2 513 940
Qira	1 178 000
Shlyerja e kredisë 48,000 euro (nga 3/2011)	621 402
Shlyerja e kredisë 100,000 lekë (nga 1/2010)	110 300
Ndryshim likuiditetesh	6 226 405
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>1 418 829</b>

**33.5.2.5** Nga analiza financiare, bazuar në dokumentacionin e administruar për znj. B. G. M., dhe bashkëshortin I. M., rezulton se huadhënësja ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e depozitës fillestare në datën 12.2.2009, si dhe të likuiditeteve të tjera të krijuara deri më 30.4.2012.

**33.5.2.6** Në përfundim të kësaj analize konkludohet se bazuar në dokumentacion e administruar gjatë hetimit administrativ, znj. B. M., ka pasur të ardhura të mjaftueshme për t'i dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 1,800,000 lekë.

**33.5.2.7** Në lidhje me kthimin e huas bazuar në dokumentacionin e depozituar nga subjekti dhe atë të administruar gjatë hetimit administrativ rezulton se:

- i. Në datën 18.2.2013, me urdhër transfertë të brendshme, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit i ka transferuar shumën prej 1,500,000 lekësh motrës së tij.

<sup>7</sup> Gjatë hetimit është evidentuar dokumenti “hapje llogarie” në “ProCredit Bank”, ku për herë të parë deklarohet e njëjta adresë për të dy. Kjo është konsideruar data e bashkëjetesës midis tyre.

Burimi i kësaj shume është depozitim i kryer nga z. A. G., në llogarinë e z. D. G., në “ProCredit Bank” me emërtim tërhequr nga “Raiffeisen Bank” në shumën 1,500,000 lekë. Nga lëvizjet në llogarinë e z. A. G., në “Raiffeisen Bank” nuk rezulton që të jetë tërhequr një shumë të tillë, ndërkohë nga z. D. G., në datën 3.1.2013 është tërhequr shuma prej 1,500,000 lekësh në këtë bankë. Nga vëzhgimi i lëvizjeve të llogarisë së z. D. G., në “Raiffeisen Bank”, rezulton se:

- në datën 28.8.2012 është derdhur në llogarinë rrjedhëse shuma prej 3,109,000 lekësh, e cila vjen nga ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 8.11.2011, për z. D. G.;<sup>8</sup>
- një pjesë e kësaj shume është investuar në fondin e investimit “Raiffeisen Invest” dhe shuma 1,500,000 lekë ka qëndruar e lirë në llogarinë rrjedhëse deri sa është tërhequr në datën 3.1.2013.

Nga analiza financiare rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e shumës prej 1,500,000 lekësh.

- ii. Në datën 31.5.2013 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar shumën 150,000 lekë në llogarinë e motrës së tij (me mandatarkëtim).
- iii. Në datën 28.3.2013 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar shumën 150,000 lekë në llogarinë e motrës së tij (me mandatarkëtim).

Në lidhje me këto dy transferime nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar shumën 300,000 lekë.

Veprimet e mësipërme financiare konfirmohen edhe nga nxjerrja e llogarisë së znj. B. M., në “ProCredit Bank”.

**33.5.3** Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit për mungesë të ardhurash të mjaftueshme në shumën 1,000,000 lekë për blerjen e pasurisë dyqan, pasi nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për hapjen e depozitës në “ProCredit Bank” në vitin 2010, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e këtij dyqani.

**33.5.4** Subjekti pas kalimit të barrës së provës prapësoi duke shpjeguar se në të gjitha deklaratat e pasurisë për vitet 2003 – 2015, nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Bashkëshorti ka tërhequr në datën 12.2.2009 nga “Tirana Bank” shumën prej 1,281,000 lekësh, për shkak se kishin filluar procedurat e legalizimit të banesës dhe do të duhej të paguanin truallin. Këto veprime nuk u mbyllën brenda vitit 2009, për pasojë lekët ishin gjendje në banesë, pasi nuk i shpenzuan për veprimin e pritshëm dhe çeljen e kësaj depozite e ka pasqyruar në deklaratën periodike të deklarimit të pasurisë për vitin 2010. Subjekti kishte në konsideratë faktin se për sa kohë lekët u tërhoqën nga banka nuk ishte nevoja të deklaroheshin gjendje *cash*.

**33.5.5** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e mbledhura gjatë hetimit administrativ, vendosi t’i përfshijë subjektit të rivlerësimit në analizën financiare shumën prej 1,281,000 lekësh. Ky vendim i Komisionit është bazuar në faktet e mëposhtme:

- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e depozitës në “Tirana Bank” në DVP-në e vitit 2007.
- Në datën 12.02.2009 bashkëshorti i subjektit ka tërhequr shumën 1,280,000 lekë nga “Tirana Bank”.
- Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar çeljen e depozitës në “ProCredit Bank” në DVP-në e vitit 2010 duke deklaruar si burim tërheqjen e shumës prej 1,280,000 lekësh nga “Tirana Bank”. Subjekti ka deklaruar shprehimisht “depozitë në emër të bashkëshortit në ‘ProCredit Bank’, datë 27.1.2010, u mbyll depozita në “Tirana Bank” dhe u hap këtu”;

---

<sup>8</sup> Verifikuar edhe me shkresën nr. \*\*\*, datë 26.1.2017, nga “\*\*\*\*” sh.a.

- Në datën 6.12.2010 bashkëshorti i subjektit së bashku me babanë e tij kanë lidhur kontratën e shitblerjes për blerjen e truallit ku është ndërtuar banesa e tyre.
- Nga analiza financiare mundësia për kursim e subjektit në fund të vitit 2009 është në vlerën 2, 776,768 lekë.
- Subjekti dhe familja e saj, nuk rezultojnë se kanë kryer shpenzime për blerje pasurie të paluajtshme/të luajtshme, për t'u justifikuar shpenzimi i kësaj shume.
- Nga shqyrtimi i deklarimeve periodike të pasurisë konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë gjendje *cash* në banesë, pavarësisht rezultativit pozitiv të analizës financiare.

**33.5.6** Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i pasaktë në plotësimin e DPV-së së vitit 2009, duke mos pasqyruar gjendjen *cash* në banesë, por në deklaratën “Vetting”, subjekti ka qartësuar si burim përdorimin e kësaj shume të tërhequr në vitin 2009 dhe të ridepozituar në vitin 2010. Në mbështetje të kësaj është edhe deklarimi i kryer në vitin 2010. Në kuptim të Ligjit Nr.9049, datë 10.4.2003”Për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive, të Detyrimeve Financiare të të Zgjedhurve dhe të disa Nëpunësve Publikë”, të ndryshuar, subjektet kanë detyrimin për të deklaruar vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj. Ky detyrim nga ana e subjektit është përmbushur, pasi ajo ka deklaruar në DVP 2007 vlerën e likuiditeteve në depozitë në Tirana Bank, duke deklaruar çeljen e kësaj depozite nga ana e bashkëshortit. Në vitin 2009 subjekti nuk kishte detyrimin ligjor në kuptim të ligjit 9049 për të deklaruar mbylljen e kësaj depozite për sa kohë ajo nuk përbënte pakësim të pasurisë së saj, por nga ana e saj duhej të saktësohej se shuma 1,280,000 e gjendur në bankë tashmë ishte gjendje *cash* në banesën e saj. Kjo pasaktësi në deklarim e subjektit është korrigjuar nga ana e saj në vitin 2010 ku ajo ka saktësuar se burimi për çeljen e depozitës në Procredit Bank ka qenë pikërisht shuma e tërhequr në Tirana Bank.

**33.5.7** Në këto kushte, duke marrë në konsideratë faktin se megjithëse shuma e tërhequr nuk është deklaruar si gjendje *cash*, por vetëm si mbyllje dhe çelje depozite që në DPV-në e vitit 2010, Komisioni vlerëson se kjo shumë duhet marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer për mundësitë e krijimit të depozitës. Për të arritur në këtë konkluzion, Komisioni ka arsyetuar duke analizuar të dhënat e përfuara prej provave të administruara përgjatë hetimit administrativ, të cilat, të vlerësuara në harmoni me njëra-tjetrën dhe të çmuara në raport me vlerën provuese të secilës, si pjesë integrale e një vlerësimi e gjykimi të mbështetur edhe në bindjen e brendshme. Ky vendim i Komisionit mbështetet edhe në vendime të formës së prerë të ngjashme, si vendim nr. 105, datë 12.2.2019 dhe vendim nr. 101, datë 23.1.2019, të Komisionit.

**33.5.8** Në përfundim të analizës për këtë pasuri rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë pasurinë dyqan, duke përdorur si burim të ardhurash depozitat në bankë, si dhe huan e marrë nga motra e bashkëshortit.

**34. Godinë banimi<sup>9</sup> 3-katëshe**, ku kati i dytë është model papafingo, me sip. 143 m<sup>2</sup> (kati përdhe) dhe sip. 20.5 m<sup>2</sup> (verandë), sip. 150.5 m<sup>2</sup> (kati i parë), sip. 192.3 m<sup>2</sup> (kati i dytë) dhe sipërfaqe truall 437.60 m<sup>2</sup>. Kjo pasuri është krijuar ndër vite, që nga viti 1997 e në vijim, ku të banueshme janë kati përdhe dhe kati i parë (me terma teknik), kati i dytë është në gjendje

<sup>9</sup> Subjekti ka depozituar: (i) certifikatë pronësie nr. \*\*\*, datë 26.1.2015, për pasurinë truall me sip. 437.60 m<sup>2</sup> nga kjo 143 m<sup>2</sup> ndërtesa; (ii) kartelë pasurie; (iii) leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 7.2.2011; (iv) kontratë kalimi pronësie së parcelës ndërtimore nr. \*\*\*, datë 6.12.2010; (v) *genplan* + faturë arkëtimi nr. \*\*\*, datë 4.10.2010, total shuma 2.074.251 lekë + njoftim për pagesat nr. \*\*\*, datë 27.10.2010 + mandat “Credins Bank” për pagesën e detyrimit të taksës së infrastrukturës në vlerën 76,989 lekë + formularët e pagesave + mandate të “Credins Bank” për kryerjen e pagesave nga shtetasi A., dhe D. G., + kartela e pasurisë + *genplan* për truallin me sip. 437.60 m<sup>2</sup>; (vi) kontratë huaje me “Procredit Bank”, me nr. \*\*\*, datë 26.7.2004; (vii) deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 3.10.2003, midis A. G., dhe L. R., ku vërtetohet se shtetasi A. G., ka marrë një shumë prej 1,000,000 lekësh nga shtetasi L. R., për shitblerje banese.

karabina, pra, i papërfunduar për të cilin nuk disponojmë dokumentacion për koston e ndërtimit, nënshtruar procedurave të legalizimit. Vlera: 6,000,000 lekë. Kjo pasuri nuk është rivlerësuar me vlerat sot pranë ZVRPP-së Tiranë. Taksa e paguar për ndikimin në infrastrukturë është 75,989 lekë. Vlera e truallit është paguar në vlerën 2,040,000 lekë, me bono privatizimi, dhe me lekë në vlerën 1,989,510 lekë.

Pjesa takuese: pasuria është në bashkëpronësi me bashkëshortin, vjehrrin dhe vjehrrën e legalizuar në bazë të lejes së legalizimit nr. \*\*\*, datë 7.2.2011 dhe trualli me kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.12.2010

**34.1 Burimi i deklaruar i krijimit:** (i) të ardhurat nga puna e deklaruases; (ii) të ardhurat e bashkëshortit nga puna në shtet dhe në sektorin privat; (iii) nga shitja e banesës në Peshkopi, pronë e familjes së bashkëshortit, me kontratën noteriale, nr. \*\*\* rep., datë 3.10.2003; (iv) të ardhurat e vjehrrit dhe të vjehrrës; (v) kredi e marrë në “ProCredit Bank” në datën 26.7.2004, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., e shlyer më 3.8.2006; (vi) dhënia me qira të një pjese të banesës; dhe (vii) shitje automjeti.

### **KONSTATIMI I ILDKPKI-së**

- *Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, si preventiv/situacion punimesh për objektin e mësipërm me sip. totale 536.4 m<sup>2</sup>, deklaruar në vlerën 6.000.000 lekë.*
- *Mosdeklarim në deklaratën e interesave private periodik vjetor të vitit 2006, të vlerës së shpenzuar për ndërtimin e shtesës së katit papafingo.*
- *Deklarim i pasaktë lidhur me vlerën totale për ndërtimin e objektit të mësipërm, pasi ndër vite rezulton e deklaruar vlera 2,000,000 lekë dhe 11,000 euro, e konvertuar shuma rreth 3.500.000 lekë, ndërsa në deklaratën e pasurisë “Vetting”, rezulton e deklaruar vlera 6.000.000 lekë, pa përfshirë vlerën e truallit, gjithashtu, referuar ALUIZNI-t, vlera e investimit në total llogaritet 15.197.821 lekë.*
- *Deklarim i pasaktë lidhur me sipërfaqen e objektit të mësipërm pasi në DPV-në e vitit 2003 është deklaruar 100 m<sup>2</sup>, në DPV-në e vitit 2004 nuk ka deklaruar sipërfaqe, në DPV-në e vitit 2006 nuk ka deklaruar sipërfaqe, në deklaratën e pasurisë “Vetting” është deklaruar sipërfaqe totale 536.4 m<sup>2</sup>.*

### **Hetimi<sup>10</sup> i kryer nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri**

#### **34.2 Mënyra e fitimit të pronësisë**

**34.2.1** Në datën 7.2.2011, me lejen e legalizimit nr. \*\*\* është legalizuar objekti, godinë banimi 3-katëshe, në emër të shtetasve A., dhe D. G.

**34.2.2** Me kontratë nr. \*\*\*, datë 6.12.2010, është bërë kalimi i pronësisë së parcelës ndërtimore me sip. 437.6 m<sup>2</sup> te bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe babai i tij. Në këtë kontratë janë përcaktuar vlerat e mëposhtme:

- i. Taksa e ndikimit në infrastrukturë në shumën 75,989 lekë, e cila rezulton e paguar në datën 1.11.2010, në “Credins Bank” nga z. D. G., (me mandatarkëtim).
- ii. Parcela ndërtimore në shumën 1,989,510 lekë, e cila rezulton e paguar në datën 1.11.2010, të “Credins Bank” nga shtetasit D., dhe A. G., (me mandatarkëtim).

---

<sup>10</sup> (i) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; (ii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar ALUIZNI-t; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.; (iv) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar OSHEE-së; (v) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2019, drejtuar OSHEE-së; (vi) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.07.2019, drejtuar ASHK-së; (vii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.10.2019, drejtuar Entit Kombëtar të Banesave.

- iii. Parcela ndërtimore letra me vlerë (bono privatizimi) në shumën 2,140,000 lekë (280,000 lekë +1,860,000 lekë), e cila rezulton e paguar në datat 1.11.2010 dhe 3.11.2010, në “Credins Bank” nga shtetasit D., dhe A. G., (me mandatarkëtim).
- iv. Penalitet dhe deklarim me vonesë në shumën 8,752 lekë, e cila rezulton e paguar në datë 1.11.2010, në “Credins Bank” nga z. D. G., (me mandatarkëtim).

**34.2.3** ZVRPP-ja Tiranë konfirmon faktin se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe babai i tij kanë në bashkëpronësi me ½ pjesë takuese pasurinë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në Rr. “\*\*\*”, hyrja -1, me sipërfaqe trualli 437.6 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 143 m<sup>2</sup>. Në kartelën e pasurisë ndërtesa specifikohet si godinë banimi 3-katëshe, ku:

- i. sipërfaqja e katit përdhes është 143 m<sup>2</sup> dhe verandë 20.6 m<sup>2</sup>;
- ii. sipërfaqja e katit të parë është 180.5 m<sup>2</sup>;
- iii. sipërfaqja e katit të dytë është 192.3 m<sup>2</sup>.

**34.2.4** Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti ka deklaruar saktë mënyrën e fitimit të kësaj pasurie.

### **34.3 Deklarimi i kësaj pasurie në vite**

**34.3.1** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si më poshtë ndërtimin e kësaj banese ndër vite:

- i. në DVP-në e vitit 2003: banesë private një kat ndërtim, sipërfaqe trualli 100 m<sup>2</sup>, vlera 2,000,000 lekë, burimi nga shitja e një banesë të familjarëve të bashkëshortit në Peshkopi;
- ii. në DVP-në e vitit 2004: shtesë kati mbi shtëpinë ekzistuese, burimi 11.000 euro kredi + të ardhura;
- iii. në DVP-në e vitit 2006: shtesa kati papafingo e papërfunduar.

**34.3.2** Nga analiza e deklarimit ndër vite për këtë pasuri rezulton se:

- i. Subjekti nuk ka deklaruar sipërfaqen e ndërtimit të katit të parë dhe papafingos në vitet 2004 dhe 2006.
- ii. Subjekti nuk ka deklaruar vlerën e ndërtimit të papafingos në vitin 2006.
- iii. Ka mospërputhje midis deklaratë “Vetting” dhe DVP-së së vitit 2003 në lidhje me burimin e të ardhurave për ndërtimin e katit përdhes, pasi në vitin 2003 deklarohen vetëm të ardhurat nga shitja e banesës së familjarëve të bashkëshortit të subjektit në Peshkopi, si dhe sipërfaqen e ndërtimit.

### **34.4 Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie**

**34.4.1** Komisioni i ka kërkuar opinion të specializuar Entit Kombëtar të Banesave në lidhje me llogaritjen e koston së ndërtimit të banesës së subjektit, për sa kohë që prej saj nuk ishte depozituar dokumentacion justifikues për të provuar vlerën e ndërtimit.

**34.4.2** Nga EKB-ja është sqaruar se nuk është në kompetencë të këtij institucioni të realizojë vlerësimin e pasurive të paluajtshme të ndërtuar privatisht. Në këto kushte, për llogaritjen e vlerës së ndërtimit të banesës në pronësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioni është mbështetur në koston mesatare të ndërtimit të përcaktuar në udhëzimet e publikuara ndër vite nga EKB-ja, vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndërkohë, në lidhje me kohën e ndërtimit Komisioni është referuar në deklaratimet e subjektit, si dhe dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

**34.4.3** Në tabelën më poshtë paraqitet analiza financiare për ndërtimin e kësaj banese e kryer nga Komisioni.

	Para 2003	2003	2004	2005	2006
<b>PASURI</b>	<b>2 577 525</b>	<b>1 099 067</b>	<b>4 068 968</b>	<b>231 286</b>	<b>4 368 806</b>
Banese 3 kate	1 827 525	1 000 000	3 831 956		4 120 155
Automjet "Daimler Chrysler" ***	500 000				
Automjet "Volswagen Golf" ***	250 000				
Automjet "Fiat Punto" ***					150 000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>		99 067	237 012	231 286	98 651
Likuiditete gjendje		99 067	336 079	567 365	666 016
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>6 289 177</b>	<b>2 044 286</b>	<b>2 070 601</b>	<b>1 765 963</b>	<b>2 955 954</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	2 345 160	605 087	760 361	773 592	798 260
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 685 228	439 199	491 063	513 570	1 208 320
Të ardhura nga z. A. G.	1 546 841				
Të ardhura nga znj. A. G.	411 948				
Interesa nga bankat			5 507	4 461	2 985
Të ardhura nga shitja e pasurive	300 000	1 000 000			900 000
Nga kreditë bankare			813 671	474 340	46 389
<b>SHPENZIME</b>	<b>3 850 089</b>	<b>375 856</b>	<b>563 431</b>	<b>987 820</b>	<b>1 587 504</b>
Shpenzime jetese	3 400 089	375 856	375 856	438 228	438 228
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>				5 514	159 010
Paguar këste për kredinë 11,000 euro			187 575	544 078	863 323
Shpenzime mobilimi (sipas pyetësorit 2)	450 000				
Shpenzime doganore për automjetet					126 943
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-138 437</b>	<b>569 363</b>	<b>-2 561 798</b>	<b>546 857</b>	<b>-3 000 355</b>

Analiza financiare është kryer duke:

- i. e konsideruar katin e tretë (papafingo) si të përfunduar plotësisht dhe jo karabina;
- ii. llogaritur vlerën e banesës sipas kostos së ndërtimit për sipërfaqe shfrytëzimi;
- iii. mos u përfshirë në analizë të ardhurat nga qiraja e banesës së subjektit dhe e punës *part time* të bashkëshortit, për shkak të mosevidentimit të pagesës së tatimeve për këto të ardhura;
- iv. mos u përfshirë në analizë financiare të ardhurat e nënës dhe babait të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, duke i konsideruar si familje më vete.
- v. përfshirë si burim kredinë e marrë në "ProCredit Bank". Nga hetimi ka rezultuar se në datën 26.7.2004 znj. B. G., me kontratën nr. \*\*\* ka marrë kredi<sup>11</sup> pranë "ProCredit Bank", në vlerën 11.000 euro, me afat 36 muaj. Debitor solidar të kësaj kredie rezultojnë subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

**34.4.4** Nga analiza financiare më sipër duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të ndërtuar këtë banesë:

- deri në vitin 2003 në shumën -138,437 lekë;
- në vitin 2004 në shumën -2,561,798 lekë;

<sup>11</sup> Si kolateral për garantimin e kredisë është vendosur hyrje 1+1 dhe truall me sip. 50 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen "\*\*\*\*\*" p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Elbasan, në pronësi të z. Z. M.

- në vitin 2006 në shumën -3,000,355 lekë.

### 34.5 Në lidhje me mundësitë për blerjen e truallit

**34.5.1** Komisioni ka kryer analizën financiare mbi mundësinë e subjektit për të blerë truallin në vitin 2010 dhe për të krijuar likuiditete në banka.

	2010
<b>PASURI</b>	<b>3 126 487</b>
Trualli për banesën 3-katëshe me sip. 437.6 m <sup>2</sup> , Rr. “***”, Tiranë	1 989 510
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	1 136 977
Likuiditete gjendje	3 568 910
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>2 796 735</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	985 441
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 752 894
Interesa nga bankat	58 400
<b>SHPENZIME</b>	<b>949 773</b>
Shpenzime jetese	546 480
Shpenzime për legalizim të ndërtesës 3-katëshe	103 293
Blerë bono privatizimi	300 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1 279 525</b>

**34.5.2** Duke qenë se për vlerën e bonove të privatizimit nuk ka të dhëna zyrtare nga institucionet bankare dhe Banka e Shqipërisë, Komisioni është mbështetur në të dhënat e vendosura në dispozicion nga subjekti, si dhe nga të dhënat në internet. Referuar një artikulli<sup>12</sup> në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave rezulton se vlera e bonove ka qenë rreth 12 %. Mbështetur në të dhënat e mësipërme vlera e bonove të privatizimit në analizë financiare është konsideruar në shumën 300,000 lekë (shumë e deklaruar nga subjekti), për arsye se norma e këmbimit e deklaruar nga subjektit është 14%, pasi vlera e truallit që është paguar me këto bono në vitin 2010 është 2,140,000 lekë.

Në këtë analizë nuk janë përfshirë: (i) të ardhurat nga qiraja, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, pasi nuk ka depozituar dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore, por dhe për të provuar dhënien me qira të një pjese të kësaj banese; (ii) shuma e tërhequr nga bashkëshorti i saj në datën 11.2.2009 në “Tirana Bank”; dhe (iii) të ardhurat, shpenzimet dhe likuiditetet e prindërve të bashkëshortit.

**34.5.3** Në këto kushte, duket se subjekti ka pasur mungesë burimesh financiare në shumën 1,279,525 lekë në vitin 2010.

**34.6** Në përfundim të hetimit administrativ subjektit iu kalua barra e provës, për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, si më poshtë vijon:

**34.6.1** Nga analiza e deklaramit ndër vite për këtë pasuri rezulton se:

- i. subjekti nuk ka deklaruar sipërfaqen e ndërtimit të katit të parë dhe papafingo në vitin 2004 dhe 2006;
- ii. subjekti nuk ka deklaruar vlerën e ndërtimit të papafingos në vitin 2006;
- iii. ka mospërputhje midis deklaratës “Vetting” dhe DVP-së së vitit 2003 në lidhje me burimin e të ardhurave për ndërtimin e katit përdhes, pasi në vitin 2003 deklarohen vetëm të

<sup>12</sup> <https://financa.gov.al/pse-e-shtyme-afatin-e-bonove-ja-kategorite-perfituese/>

ardhurat nga shitja e banesës së familjarëve të bashkëshortit të subjektit në Peshkopi, si dhe sipërfaqen e ndërtimit.

**34.6.2** Nga analiza financiare duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të ndërtuar këtë banesë:

- i. deri në vitin 2003 në shumën -138,437 lekë;
- ii. në vitin 2004 në shumën -2,561,798 lekë;
- iii. në vitin 2006 në shumën -3,000,355 lekë.

**34.6.3** Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të blerë truallin në vitin 2010 dhe për të krijuar likuiditete në banka në shumën 1,279,525 lekë.

**34.7** Pas kalimit të barrës së provës, së bashku me dokumentacionin mbështetës, subjekti ka parashtruar se:

**i.** Banesa është në bashkëpronësi me vjehrrin në ½ pjesë ideale, sikundër rezulton nga certifikata e pronësisë datë 26.1.2015, lëshuar nga ish-ZVRPP-ja Tiranë, sot ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë. Kontributi i ndërtimit të banesës dhe blerjes së truallit duhet të llogaritet nga të dy bashkëpronarët, pra, D. G., dhe A. G. Pavarësisht gjendjes civile të dy kurorave, nën hetim administrativ është pasuria ndërtesë dhe truall, e cila është në bashkëpronësi të dy personave, të cilët kanë një lidhje të posaçme, sepse janë atë e bir.

**ii.** Për sa i përket mosdeklarimit të sipërfaqes së banimit të katit i parë dhe të papafingos, ky është një lapsus nga subjekti, pasi duke u shprehur ndërtim shtesë kati e ka konsideruar të mjaftueshëm deklarimin, kjo mënyrë të deklaruarit vjen edhe për shkak të mungesës së njohurive të posaçme në fushën e ndërtimit, i cili është mjaft teknik.

**iii.** Për sa i përket deklarimit të burimit të krijimit të kësaj pasurie, ku në deklaratën e vitit 2003 si burim ka deklaruar shitjen e banesës së prindërve të bashkëshortit në Peshkopi, ajo që subjekti ka dashur të thotë është se edhe kjo vlerë ka shërbyer për ndërtimin e banesës, por që padyshim burimi bazë i krijimit të saj kanë qenë të ardhurat familjare të përbashkëta. Më qartë dhe saktë burimi i krijimit të kësaj pasurie është shprehur në deklaratën “Vetting”, së bashku me vlerën e ndërtimit të saj.

**iv.** Për sa i përket vlerës së ndërtimit objekt shtëpi banimi, subjekti i ka qëndruar deklarimit “Vetting” se vlera e ndërtimit të kësaj banese është 6,000,000 lekë. Mosdeklarimin e plotë të vlerës së banesës në deklaratat periodike të deklarimit të pasurisë subjekti e ka konsideruar një pakujdesi, duke menduar që pasqyrimi i ndërtimit është i mjaftueshëm.

**v.** Në lidhje me metodën e përdorur nga Komisioni në kushtet kur ky ndërtim është realizuar në mënyrë informale, pra nuk ka leje ndërtimi, as projekt, as preventiv etj., subjekti ka parashtruar se vlera e ndërtimit të banesës duhet të llogaritet me metodën që i përfaqësohet mënyrës së ndërtimit të saj dhe kjo metodë është ajo me vlerat e çmimit mesatar sipas zërave të punimeve për qytetin e Tiranës. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit shkresën kthim-përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2019, të lëshuar nga Enti Kombëtar i Banesave, ku janë përcaktuar çmimet mesatare sipas zërave të punës për vitet 1998,1999, 2000, 2001, 2002, 2003, 2004, 2005, 2006, që i përkasin kohës kur është ndërtuar banesa. Subjekti ka kërkuar që nga Komisioni përlllogaritja e vlerës së banesës të behet sipas mënyrës që ajo ka shpjeguar, pra blerjes së materialeve dhe më pas ato futeshin në punë në ndërtimin e banesës ku fuqia punëtore ka qenë vjehri dhe bashkëshorti dhe në disa raste edhe punëtorë me pagesë. Ajo ka deklaruar se punimet për rrjetin elektrik janë kryer nga bashkëshorti i saj, i cili është inxhinier elektrik dhe aktualisht ka licencë për kryerjen e akteve të ekspertimit në këtë fushë, si dhe nuk ka marrë firmë ndërtimi për ndërtimin e banesës.



**vi.** Subjekti ka pretenduar se Komisioni, llogarinë e kostos së ndërtimit duhet ta bënte sipas sipërfaqes së ndërtimit dhe jo të shfrytëzimit. Gjithashtu, ajo deklaroi se ndërtimi i dy kateve ka filluar në vitin 2004 dhe ka përfunduar në vitin 2006.

**vii.** Sipas subjektit, në lidhje me katin papafingo, kostoja e përdorur përfaqëson një ndërtim të përfunduar me të gjitha rifiniturat. Në fakt, sipas saj, ky kat është i papërfunduar, siç pasqyrohet në pamjet fotografike. Konkretisht, ky kat është në gjendje karabinaje, nuk kanë përfunduar ndarjet e ambienteve përbërëse të tij, është pa përfunduar me rifinitura, pa tavane, pa dyer e dritare, pa instalimet elektrike dhe hidraulike + pajisjet hidrosanitare, pa shtresat e dyshemesë, pa suvatime, bojatisje etj., prandaj duhet të llogaritet me volume e punimeve të realizuara me çmimet e EKB-së në vitin e realizimit të punimeve.

**viii.** Në lidhje me mundësinë e blerjes së truallit subjekti deklaroi se është në bashkëpronësi me vjehrrin A. G., dhe bashkëshortin e saj D. G. Mosqenia e dy kurorave në një certifikatë familjare nuk përjashton kontributin e secilit bashkëpronar në blerjen e truallit. Vlera në total e parcelës ndërtimore plus shpenzimet për legalizim prej 2,392,803 lekësh (1,989,510 lekë +103,293+300,000) është paguar nga shtetasit D., dhe A. G. Subjekti ka pretenduar se nuk mundet që kjo vlerë të ngarkohet vetëm në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, për sa kohë trualli është në bashkëpronësi.

**ix.** Në vitin 2010 nuk është marrë në konsideratë në krijimin e të ardhurave të ligjshme vlera e qirasë në shumën 400,000 lekë, sipas vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve.

**x.** Në lidhje me mospasjen e kontratave të qirasë subjekti shpjegon se ambientet që japin me qira kryesisht janë për studentë, kontratat kanë qenë me shkrim dore ose verbale, dhe meqenëse kanë qenë për periudhë njëvjeçare, në zbatim të nenit 803, të Kodit Civil, nuk kanë pasur detyrim t'i lidhnin me shkresë.

**34.8** Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit, si dhe dokumentacionin e depozituar, vlerëson se:

**34.8.1** Në analizën financiare të subjektit duhet të përfshihen:

**i.** Të ardhurat e nënës dhe të babait të bashkëshortit të subjektit, për sa kohë ka rezultuar se banesa është e regjistruar në ASHK-në Tiranë në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit dhe babait të tij. Gjithashtu, kjo rezulton në aplikimin pranë ALUIZNI-t, në lejen e legalizimit, si dhe në kontratën për kalimin e parcelës ndërtimore figurojnë emrat e z. D. G., bashkëshorti i subjektit, dhe z. A. G., babai i tij. Për rrjedhojë, provohet që banesa është në bashkëpronësi, duke u marrë e mirëqenë se secili nga bashkëpronarët ka kontribuar për ndërtimin e saj të paktën në masën 50 % me 50 %, për sa kohë nuk ka asnjë dokument tjetër për të provuar të kundërtën.

**ii.** Të ardhurat nga dhënia me qira e një pjese të banesës. Këto të ardhura rezultojnë të deklaruara në DPV-të, por dhe në deklaratën “Vetting”, si dhe subjekti ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tiranë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, që provon pagesën e tatimit në burim për dhënien me qira të një pjese të banesës. Në këtë vërtetim deklarohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, si individ privat për tatimin mbi të ardhurat individuale në bazë të formularit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për vitet 2011 – 2016 (tatim qiraje dhe të ardhura *bruto* të tjera të papërmendura më lart), ka deklaruar të ardhura si më poshtë vijon:

Viti	Totali i të ardhurave bruto	Tatimi i paguar
2011	3,240,000	324,000
2012	444,444	44,000

2014	296,667	29,667
2015	166,000	24,900
2016	197,647	29,647

Subjekti, bazuar në nenin 803<sup>13</sup> paragrafi i fundit të Kodit Civil, nuk kishte detyrimin ligjor të lidhte kontratë me shkrim. Komisioni vlerëson se për sa kohë subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e banesës në DVP-të e viteve 2004 – 2016, si dhe ka paguar detyrimet përkatëse, provohet edhe ekzistenca e dhënies me qira, për sa kohë bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016 deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni.

**iii.** Të ardhurat nga puna *part time* e bashkëshortit në vitet 2004 - 2005 në shumën 400,000 lekë. Këto të ardhura duhet të përfshihen, pasi subjekti i ka deklaruar në DPV-të, si dhe rezultojnë të ketë paguar detyrimet tatimore referuar vërtetimit nr. \*\*\*, të DRT-së Tiranë.

**iv.** Shuma 1,281,000 lekë e tërhequr nga “Tirana Bank” (referohu në pikën 33.5.5-33.5.7 të këtij vendimi).

**34.8.2** Duke u mbështetur në përgjigjet e subjektit, provat e paraqitura prej saj, si dhe faktet e mbledhura gjatë hetimit administrativ, kati papafingo të konsiderohet i papërfunduar. Ky vlerësim i Komisionit mbështet në fotot e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe pas kalimit të barrës së provës, por dhe në fotot e gjendura në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019, të ALUIZNI-t, nga ku provohet se gjendja faktike e katit të fundit është e papërfunduar. Duke qenë se kati i fundit do të konsiderohet i papërfunduar, vlera e tij në analizën financiare është llogaritur në gjendje karabina, duke marrë koeficientin 44.1 %, e përcaktuar në dokumentin nr. \*\*\*, datë 17.5.2006 “Marrëveshje për përcaktimin e treguesve minimalë për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim” midis \*\*\* dhe DPT-së. Në këtë vlerësim, Komisioni ka pasur parasysh ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i cili në germën “a” të nenit 3, jep këtë përkufizim për ndërtimin pa leje, që objekti të pranohej për legalizim dhe në fazën karabina: “ *‘Ndërtim pa leje’ është objekti, për të cilin është përfunduar karabinaja, i destinuar për banim, veprimtari ekonomike dhe/ose funksione të tjera, (si, për shembull, social-kulturor, arsim, shëndetësi e të tjera të këtij lloji), për të cilin nuk janë respektuar procedurat e përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi për planifikimin e territorit*”.

Komisioni, në lidhje me këtë kat, konstaton se subjekti është treguar e pakujdesshme kur ka pranuar që në ZVRPP regjistrimi i tij të bëhej si i përfunduar, por kjo pakujdesi e saj nuk mund të përbëjë shkak për ta penalizuar në procesin e rivlerësimit, i cili ka për objekt kontrollin e pasurisë së subjekteve të rivlerësimit me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” e ka deklaruar saktë këtë pasuri, si dhe nuk ka tentuar ta fshehtë apo ta paraqesë në mënyrë të pasaktë.

**34.8.3** Trupi gjykues vlerëson se kostoja e ndërtimit të banesës duhet të merret në vlerën e kostos së ndërtimit për sipërfaqe ndërtimi, sikundër është marrë në konsideratë në vendimin nr. \*\*\*/2019, të Kolegjit të Apelit, por dhe në të gjitha rastet e tjera të ngjashëm të shqyrtuara nga Komisioni.

<sup>13</sup> Kontrata e qirasë, për një kohë më të gjatë se një vit, duhet bërë me shkresë.

**34.9** Komisioni, bazuar në vlerësimin e mësipërm, ka kryer një analizë të re financiare, si më poshtë vijon:

**a.** Kati përdhes me sip. 143 m<sup>2</sup>.

Viti i fillimit të ndërtimit është konsideruar viti 1997 dhe viti i përfundimit 2003. Ky konkluzion është bazuar në deklaratimet e subjektit në DVP-në e vitit 2003, nga të dhënat e OSHEE ku rezulton se kontrata është lidhur para vitit 2003, si dhe nga fakti se subjekti në vitin 2004 ka aplikuar për kredi për të ndërtuar katin e parë. Vlera e kostos së ndërtimit bazuar në udhëzimet e EKB-së sipas viteve respektive të ndërtimit është:

Vendimi/udhëzimi	Viti	Çmimi i ndërtimit/m <sup>2</sup>	Shënime	Sip. e ndërtuar sipas viteve	Vlera në lekë <sup>14</sup>
Vendim nr. ***, datë 5.1.1998	1997	16 138	Shkallë Republike	53.00	634 985
Vendim nr. ***, datë 28.4.1999	1998	21 985	Shkallë Republike	26.50	432 524
	1999	21 985	Shkallë Republike	6.63	108 131
Vendim nr. ***, datë 14.7.2000	2000	24 780	Tirane	6.63	121 878
Udhëzim nr. ***, datë 21.5.2001	2001	28 641	Tirane	6.63	140 868
Udhëzim nr. ***, datë 16.10.2002	2002	22 150	Tirane	6.63	108 943
Udhëzim nr. ***, datë 8.5.2003	2003	22 615	Tirane	37.00	621 207
<b>Vlera e katit përdhes</b>				<b>143.00</b>	<b>2 168 536</b>

Në llogaritjen e vlerës së ndërtimit të katit përdhes është zbritur nga çmim/m<sup>2</sup> shumatorja e vlerave që përfaqëson TVSh + Fitim + Fond rezervë<sup>15</sup> dhe është konsideruar çmimi i ndërtimit për sipërfaqe ndërtimi sipas vendimit nr. 15/2019, të KPA-së.

**b.** Kati i parë me sip. 180.5 m<sup>2</sup> dhe kati i dytë (papafingo) me sip. 192.3 m<sup>2</sup>

Viti i ndërtimit është konsideruar viti 2004 dhe viti i përfundimit 2006. Është konsideruar si vit fillimi për ndërtimin e katit të parë viti 2004, pasi subjekti e ka deklaruar këtë fakt në DVP-në e vitit 2004, por dhe në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, në këtë vit është marrë dhe kredia në shumën 11,000 euro, e cila ka shërbyer si burim për ndërtimin e katit të parë. Në vitin 2004 është tërhequr/përdorur nga kredia shuma 6,420 euro, ose 813,671 lekë; në vitin 2005 është tërhequr shuma 3,871 euro ose 474,340 lekë; dhe në vitin 2006 shuma 375 euro, ose 46,389 lekë.

Viti 2006 është konsideruar si vit i përfundimit të dy kateve, pasi bashkëshorti i subjektit dhe babai kanë bërë aplikim në datën 15.11.2006 pranë ALUZINI-t, si dhe nga fotot e depozituara rezulton se kati i dytë ka qenë i përfunduar si ndërtim. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar gjatë hetimit por edhe në përgjigje të rezultateve të hetimit që kati i parë edhe i dytë është ndërtuar në periudhën 2004 – 2006.

<sup>14</sup> Vendimi nr. 15/2019, i KPA-së.

<sup>15</sup> Udhëzimi nr. \*\*\*, datë 8.5.2003, i EKB-së, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

Vlera e koston së ndërtimit është llogaritur, si më poshtë:

Vendimi/udhëzimi	Viti	Çmimi i ndërtimit	Shënime	Sip. ndërtuar sipas viteve	Vlera në lekë <sup>16</sup>
Udhëzim Nr. ***, datë 4.3.2004	2004	24 446	Tiranë	180.5	<b>3 275 842</b>
Udhëzim Nr. ***, datë 7.9.2006	2006	25 262	Tiranë	192.3	<b>1 590 463</b>
<b>Shuma</b>					<b>4 866 305</b>

- Kati i dytë (papafingo) është konsideruar në gjendje karabina, sikurse ka deklaruar subjekti. Vlera e ndërtimit të plotë, është *ponderuar* me përqindjen e punimeve që i takojnë kësaj faze<sup>17</sup>.
- Shpenzimi për vlerën e ndërtimit të katit të parë dhe të dytë, në shumën 4,866,305 lekë, është ndarë në mënyrë të barabartë për vitet 2004, 2005 dhe 2006. Kjo ndarje është bërë për arsye se nga ana e Komisionit është e pamundur për të përcaktuar vlerën e saktë për çdo vit. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti në vitin 2005 ka tërhequr shumën 3871 euro të kredisë, e cila është deklaruar nga ana e saj në deklaratën VETTING si burim për ndërtimin e katit të parë për rrjedhojë në analizë financiare ndërtimit i katit të parë është llogaritur si i ndërtuar gjatë viteve 2004-2005.

Në llogaritjen e vlerës së ndërtimit të katit të parë është zbritur nga çmimi për metër katror, shumatorja e vlerave që përfaqëson TVSh + Fitim + Fond rezervë<sup>18</sup> dhe është konsideruar çmimi i ndërtimit për sipërfaqe ndërtimi sikundër është llogaritur në vendimin nr. 15/2019, i KPA-së .

Investimi total për ndërtimin e banesës 3-katëshe, duke filluar nga viti 1997 dhe deri në vitin 2006, është në vlerën 7,034,841 lekë.

#### Analizë financiare

	2003	2004	2005	2006
<b>PASURI</b>	<b>3 017 602</b>	<b>1 859 114</b>	<b>1 853 388</b>	<b>1 870 752</b>
Banese 3-katëshe	2 168 536	1 622 102	1 622 102	1 622 102
Automjet, tip "Daimler Chrysler" ***	500 000			
Automjet "Volswagen Golf" ***	250 000			
Automjet "Fiat Punto" ***				150 000
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	99 067	237 012	231 286	98 651
Likuiditete/Gjendje	99 067	336 079	567 365	<b>666 016</b>
<b>TË ARDHURA dokumentuar</b>	<b>8 363 639</b>	<b>2 707 872</b>	<b>2 354 584</b>	<b>3 713 618</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	2 950 247	760 361	773 592	798 260
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	2 124 427	491 063	513 570	1 208 320
Të ardhura nga paga e bashkëshortit <i>part-time</i>		200 000	200 000	
Të ardhura nga A. G. (babai b/shortit)	1 784 571	257 271	208 621	577 664

<sup>17</sup> Dokumentacion ligjor tatimor për aktivitetin në fushën e ndërtimit, Ministria e Financave, DPT, vitet 2006 – 2007.

<sup>18</sup> Udhëzimi nr. \*\*\* datë 8.5.2003 "Për klasifikimin dhe strukturën e koston së punimeve të ndërtimit" EKB

Të ardhura nga A. G. (nëna b/shortit)	204 394			
Të ardhura nga qiraja		180 000	180 000	180 000
Interesa nga bankat		5 507	4 461	2 985
Të ardhura nga shitja e pasurive	1 300 000			900 000
Nga kreditë bankare		813 671	474 340	46 389
<b>SHPENZIME</b>	<b>3 878 506</b>	<b>657 395</b>	<b>1 097 377</b>	<b>1 645 162</b>
Shpenzime jetese	3 428 506	469 820	547 785	547 785
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>		0	5 514	107 110
Paguar këste për kreditë 11,000 euro		187 575	544 078	863 323
Shpenzime mobilimi ( <i>sipas pyetësorit 2</i> )	450 000			
Shpenzime doganore për automjetet				126 943
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>1 467 530</b>	<b>191 363</b>	<b>-596 181</b>	<b>197 704</b>

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka të ardhura të mjaftueshme në vlerën -596,181 lekë vetëm për vitin 2005.

Komisioni, në vlerësimin e tij përfundimtar për këtë pasuri, mban në konsideratë edhe:

- i. Në llogaritjen e vlerës së kësaj banese përfshihen në koston e ndërtimit të katit të parë dhe të papafingos, edhe shpenzimet për punimet e dheut, themelet, të cilat, në fakt, në ndërtimin e këtyre kateve nuk mund të bëheshin sërish, pasi janë kryer kur është ndërtuar kati përdhe, por për shkak se Komisioni e ka të pamundur për t'i ndarë si zëra më vete, janë përfshirë në llogaritjen e koston së këtyre kateve.
- ii. Në llogaritjen e banesës janë përfshirë edhe kostot e instalimeve elektrike, të cilat sërish kanë qenë të pamundura për t'u ndarë, ndërkohë që është fakt që bashkëshorti i subjektit është inxhinier elektrik dhe ushtron aktivitetin si zyrë inxhinierike duke kryer edhe akte ekspertimi, pra, ka qenë në gjendje që t'i kryejë vetë këto punime, pa kosto.
- iii. Në llogaritjen e katit të parë nuk është marrë në konsideratë kosto e llogaritur nga eksperti P. A., në preventivin e dorëzuar në "ProCredit Bank" për përfitimin e kredisë. Sipas këtij preventivi të ndërtimit, që ndodhet në dosjen e kredisë të administruar nëpërmjet "ProCredit Bank" vlera e katit të parë, është 1,458,240 lekë.

**34.10** Duke vënë në balancë vlerën e rezultatit negativ në vitin 2005, në raport me provat e tjera të administruara nga Komisioni, nëpërmjet hetimit të tij, vlerësohet se balanca negative në vitin 2005 nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikën 1 dhe 3 të nenit 61.

**34.11** Në lidhje me pasaktësitë e konstatuara për sa i përket mosdeklarimit të vlerës së ndërtimit në DVP-në e vitit 2006, mosdeklarimit të sipërfaqes së ndërtimit në DVP-të e viteve 2004 dhe 2006, si dhe mospërputhjes midis deklaratës "Vetting" dhe DVP-së së vitit 2003 në lidhje me burimin e të ardhurave për ndërtimin e katit përdhe dhe sipërfaqes së ndërtimit, Komisioni vlerëson se këto pasaktësi janë bërë në deklaratat periodike dhe nuk ndikojnë në analizën financiare, si dhe nuk kanë pasur për qëllim fshehjen apo paraqitjen e pasaktë të pronës. Këto pasaktësi janë rregulluar me plotësimin e deklaratës "Vetting" ku subjekti ka deklaruar saktë pasurinë, si dhe burimin e ligjshëm të ardhurave.

**34.12** Në lidhje me vlerën e shtëpisë së deklaruar nga subjekti në deklaratën "Vetting", Komisioni konstaton se nuk përpunet me analizën e kryer më sipër. Duke pasur parasysh se vlera e deklaruar nga subjekti nuk është një vlerë e dokumentuar me fatura shpenzimi apo pagese, duke pasur parasysh se analiza financiare e kryer nga njësia e shërbimit ligjor nuk ka marrë në

konsideratë disa argumente të paraqitura nga subjekti, si dhe raportin e vlerësimit të kryer nga eksperti i licencuar i caktuar nga “ProCredit Bank” në momentin e dhënies së kredisë, duke marrë parasysh se është e pamundur të vlerësosh realisht në shuma fikse shpenzimet për rrjetin elektrik apo vlerën e fuqisë punëtore të përdorur, duke pasur parasysh se diferenca e vlerës së llogaritur nga Komisioni me atë të deklaruar nga subjekti nuk është e konsiderueshme, trupi gjykues vlerëson se nuk jemi në kushtet e deklarimit të rremë apo të pasaktë në kuptim të ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti ka deklaruar një shumë për të cilën mendon se ka shpenzuar për ndërtimin e banesës, në kushtet kur mungojnë dokumentacioni provues për ndërtimin e saj duke qenë se kemi të bëjmë me një ndërtim informal.

**34.13.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklaratimet e tij në deklaratën “Vetting” në lidhje me këtë pasuri.

**35. Aksione<sup>19</sup>** në shoqërinë “\*\*\*” sh.a., blerë bono privatizimi, në vlerën 50,000 lekë (në datën 13.1.2008, nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike, në emrin tim të deklarueses Alkelina Gazidedja, pasi bashkëshorti ka qenë punonjës i ndërmarrjes e cila u privatizua. Pjesa takuese: 0.000333333333%

**36. Aksione** në shoqërinë “\*\*\*” sh.a., blerë me bono privatizimi në vlerën 50,000 lekë, në datën 13.1.2008, nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike në emrin e bashkëshortit D. G., pasi ka qenë punonjës i ndërmarrjes, e cila u privatizua. Pjesa takuese: 0 %

## KONSTATIMI I ILDKPI-së

*Rezulton se subjekti ka shkelur ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar. Referuar përgjigjes së Agjencisë së Prokurimit Publik, rezulton se nga data 3.6.2014 deri më 25.1.2017, shoqëria “\*\*\*”, ku subjekti, bashkëshorti, prindërit e bashkëshortit, janë aksionerë të saj, është shpallur fituese dhe ka lidhur në total 113 kontrata me institucione të ndryshme publike.*

## Rezultati i hetimit<sup>20</sup>

**36.1** Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit deklaroi se: (i) ka blerë aksione në shoqërinë “\*\*\*” në vitin 2008, si familjar i punonjësit (bashkëshortit), në këtë shoqëri, në momentin e privatizimit, në vlerën 50,000 lekë, në bashkëpronësi të familjes; (ii) personi i lidhur/bashkëshortit i subjektit të rivlerësimit deklaroi se ka blerë aksione në shoqërinë “\*\*\*” në vitin 2008, si punonjës në këtë shoqëri, në momentin e privatizimit, në shumën 50,000 lekë.

Nga hetimi administrativ kryesisht, u konstatua se:

**36.2** Bazuar në shkresën e shoqërisë “\*\*\*” sh.a., të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit rezulton se duke filluar nga data 23.4.2009 subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti i saj, si dhe prindërit e tij janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë “\*\*\*” sh.a., me të dhënat, si më poshtë vijon:

Emër mbiemër	Nr. rendor	Aksione të zotëruara në %
A. Q. G.	46	0.0005%
A. H. G.	159	0.0005%

<sup>19</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion: vërtetim nr. \*\*\*, datë 27.1.2017, nga “\*\*\*” sh.a.

<sup>20</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar QKB-së.

Alkelina Z. Gazidedja	402	0.0003333333%
D. A. G.	1551	0.0003333333%

Nga ana e kësaj shoqërie deklarohet se nuk është shpërndarë asnjëherë dividend.

**36.3** Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2017, administruar nga dosja e ardhur nga ILDKPKI-ja, informon se nga data 3.6.2014 deri më 25.1.2017, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., ku subjekti i rivlerësimit, bashkëshorti dhe prindërit e bashkëshortit, janë aksionerë të saj është shpallur fituese dhe ka lidhur në total 113 kontrata me institucione të ndryshme publike.

**36.4** Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në nenin 21, pika 1, përcaktohet se: “Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”. Në nenin 24, pika 1, të këtij ligji përcaktohet se: “Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 dhe në nenin 22 të këtij ligji, përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es”

**36.5** Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova, pasi konstatoi se në lidhje me pronësinë këtyre aksioneve, subjekti i rivlerësimit është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

**36.6** Në shpjegimet e tij subjekti deklaroi se bashkëshorti i saj z. D. G., ka qenë punonjës i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., dhe në momentin e privatizimit, shteti parashikoi që një pjesë e aksioneve më pak se 5% e tyre të privatizohen nga punonjësit e kësaj ndërmarrjeje sipas gjendjes së certifikatës familjare, personat madhore të familjes. Kjo me qëllim që letrat me vlerë të shpërndara nga shteti të mund të gjenin një formë përdorimi. Sipas provave të depozituar kanë blerë pjesë të aksioneve me letra me vlerë... Ajo që ka lidhur kontrata është shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., e cila duke qenë se në përbërje të aksionerëve të saj ka pasur prokurorë, gjyqtarë do të duhej të mos kryente asnjë procedurë prokurimi në ndalim të nenit 21, pika 1, të ligjit. Subjektit nuk i rezulton se për çdo rast që shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., ka marrë pjesë në këto procedura, si dhe ka lidhur kontratat përkatëse, të ketë informuar me qëllim konstatimin e ekzistencën së ndalimit ligjor të parashikuar nga pika 1, e nenit 21, të ligjit nr. 9367 me qëllim që ajo si subjekt i ligjit dhe familjarët e saj si persona të lidhur në kuptim të dispozitave të mësipërme së pari të kishim mundësinë t’i shpjegojmë shoqërisë se ajo nuk mund të lidhte këto kontrata dhe së dyti nëse shoqëria nuk do të dëgjonte vullnetin e tyre atëherë ne të merrnim masa për të shmangur konfliktin e interesit.

**36.7** Referuar shkresës kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 2.12.2019, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., sqaron se: “Si një shoqëri aksionere shumicën e aksioneve prej 80.274% i zotëron \*\*\*, ndërsa pjesa që zotërohet nga ish-punonjës të ‘\*\*\*\*’ sh.a., dhe familjarë të tyre përbën 3.478 % të aksioneve të ‘\*\*\*’ sh.a. Këtë përqindje prej 3.478 % në ‘\*\*\*\*’ sh.a., e zotërojnë 7168 persona fizikë ku bëjnë pjesë dhe aksionerët A., A. A., dhe D. G. Në këto kushte duke marrë në konsideratë përqindjen e ulët prej 3.478 % që zotërojnë këto aksionerë, si dhe numrin e madh prej tyre prej 7168 persona fizikë është e pamundur që ‘\*\*\*\*’ sh.a., t’i njoftoj ata për çdo transaksion, kontratë sipërmarrje apo procedura tenderimi që realizon gjatë aktivitetit të saj me qëllim verifikimi nëse ndonjëri ka apo mund të ketë ndonjë konflikt interesi. Për sa më sipër ju informojmë se nuk kemi

*njoftuar subjektin Alkelina Gazidedja në lidhje me kontratat e lidhura që lidhin nga veprimtaria tregtare e shoqërisë ‘\*\*\*’ sh.a.”*

**36.8** Subjekti deklaroi se familjarët e saj morën menjëherë masa për shmangien e konfliktit të interesit duke i dhuruar aksionet e tyre sikundër provohet nga vërtetimi i kryerjes së aplikimit, datë 27.11.2019, në QKB.

**36.9** Komisioni vlerëson se ligjvënësi ka përcaktuar mënyrat bazë të trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave nga zyrtarët, për parandalimin sa më të hershëm dhe sa më efikas të çdo konflikti të interesit, të çdo lloji qoftë ai. Referuar nenit 37, të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005”, parashikohet se zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë. Mënjanimi apo parandalimi i konfliktit të interesit nga zyrtari lidhet me dijeninë e tij për situatën dhe rrethanën që e krijojnë atë, gjendur në këto kushte subjekti më anë të tjetërsimit të interesave privatë, duke dhuruar aksionet në emër të tij dhe familjarëve të tij, bëri të mundur zgjidhjen e situatës së konfliktit të interesit në momentin që mori dijeninë.

**36.10** Komisioni vlerësoi gjithashtu faktin që subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk rezultojnë të kenë lidhur kontrata apo nënkontrata me ndonjë institucion publik, vlera e këtyre aksioneve të zotëruara nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij është shumë e ulët, vetëm 0.000333333333% secili, dhe për sa kohë që provohet burimi i ligjshëm i tyre, e përjashtojnë rrezikun e gjendjes në situatën e parashikuar në gjerat “b”, “c”, “ç”, të pikës 5, të nenit 33, si dhe në situatën e parashikuar në gjerat “d”, të ligjit nr. 84/2016, duke shmangur gjendjen në konflikt të interesit me tjetërsimin/dhurimin e aksioneve. Pavarësisht nga fakti që shoqëria ka marrë pjesë në tender apo ka lidhur kontrata, subjekti nuk ka pasur rol vendimmarrës duke qenë se vlera e aksioneve ka qenë e papërfillshme dhe për këtë arsye nuk provohet asnjë lloj konflikti. Komisioni e mbështet vendimin e tij edhe në vendimin e formës së prerë nr. 176, datë 8.7.2019, të Komisionit.

**37. Tokë arë<sup>21</sup>** ndodhur në fshatin \*\*\*, Dibër, e cila figuron në emër të babait të bashkëshortit, tokë e fituar me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën”, sipas gjendjes familjare, datë 1.8.1991, me sip. 1920 m<sup>2</sup>.

**37.1** Burimi i deklaruar i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: akti i marrjes i tokës në pronësi nr. \*\*\*, datë 19.2.1995.

### **Rezultati i hetimit<sup>22</sup>**

**37.2** Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Dibër, rezultojnë se babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka të regjistruar pasuritë e mëposhtme të paluajtshme në z. k. \*\*\*, \*\*\*, Dibër:

- i. lloji i pasurisë, arë me sip. 1200 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*,
- ii. lloji i pasurisë, arë me sip. 1000 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*.

Origjina e këtyre pasurive është akti i marrjes së tokës në pronësi nr. \*\*\*, datë 19.12.1995, nëpërmjet të cilit babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit ka përfitur tokë bujqësore me sip. 1920 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Dibër.

**37.3** Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me mospërputhjen midis sipërfaqes së regjistruar (2200 m<sup>2</sup>) dhe asaj të përfitur nga AMTP-ja (1920 m<sup>2</sup>). Subjekti sqaroi se: “Nga shkresa kthim përgjigjeje e datës 17.7.2019, me nr. \*\*\* prot., lëshuar nga Agjencia Shtetërore e

<sup>21</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion: akti i marrjes i tokës në pronësi nr. \*\*\*, datë 19.2.1995, me sip. 1920 m<sup>2</sup> + kartel pasurie, në emër të A. G.

<sup>22</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme.



*Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër, rezulton se diferenca midis sipërfaqes të dhënë në aktin e marrjes së tokës në pronësi me regjistrimin në ZVRPP-ja Dibër ka ardhur nga matjet në terren të LN shkurt 1998 nga këto matje rezulton që në terren sipërfaqja prej 840 m<sup>2</sup> është 1000 m<sup>2</sup> dhe sip, prej 1080 m<sup>2</sup> është 1200 m<sup>2</sup>.*

Për të provuar deklaratimet e saj subjekti depozitoi edhe shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 17.7.2019, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Dibër.

**37.4** Nga subjekti i rivlerësimit është shpjeguar qartë dhe është depozituar dokumentacion i plotë provues në lidhje me këtë pasuri. Komisioni nuk konstaton probleme në lidhje me këtë pasuri.

**38. Tokë arë**<sup>23</sup> dhe truall ndodhur në fshatin \*\*\*, Lushnjë, e përfituar nga ligji nr. 7501/1991, e pandarë së bashku me pjesëtarët e tjerë të familjes, 15 dynym, sipas dy certifikatave të pasurisë, datë 22.4.2005, lëshuar nga ZVRPP-ja Lushnjë në emër të kryefamiljarit sipas gjendjes familjare në datën 1.8.1991.

**38.1** Burimi i krijimit: ligji nr. 7501/1991, “Për tokën”.

### **Rezultati i hetimit**<sup>24</sup>

**38.2** Bazuar në certifikatat e pronësisë të depozituar nga subjektit të rivlerësimit rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi:

- Pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në \*\*\*, Lushnjë, me sipërfaqe totale 2.000 m<sup>2</sup> e llojit arë+truall nga kjo sipërfaqe truall 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 100 m<sup>2</sup>.
- Pasuri nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, ndodhur në \*\*\* Lushnjë me sipërfaqe totale 13.000 m<sup>2</sup> e llojit arë.

**38.3** Subjekti gjatë hetimit vuri në dispozicion të Komisionit dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 15.7.2019, të Drejtorisë Vendore Lushnjë (ASHK) në të cilin vërtetohet se: subjekti i Rivlerësimit ka në bashkëpronësi pasuri të përfituara sipas ligjit nr. 7501/1991, në emër të z. Z. M.
- Shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\* prot., datë 19.7.2019, të Bashkisë Lushnjë, e cila ka vënë në dispozicion AMTP-së në emër të z. Z. M., nga ku rezulton se ka përfituar 15.100 m<sup>2</sup> tokë bujqësore nga të cilat 300 m<sup>2</sup> truall

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit rezulton se origjina e kësaj pasurie është Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi nr. \*\*\* prot., datë 10.5.1993, lëshuar dublikatë me aktin nr. \*\*\*, datë 18.7.2019.

**38.4** Nga subjekti i rivlerësimit është shpjeguar qartë dhe është depozituar dokumentacion i plotë provues në lidhje me këtë pasuri. Nuk rezultojnë dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri.

**39. Llogari rrjedhëse**<sup>25</sup> në “ProCredit Bank”, në emër të subjektit e mbyllur në datën 18.1.2017. Vlera: 28,419 lekë.

**40. Llogari kursimi** në “ProCredit Bank” e mbyllur në datën 18.1.2017, në emër të subjektit në vlerën 11.555 lekë. Interesa të përfituara nga depozita tashmë e mbyllur ndër vite në “ProCredit Bank” sipas vërtetimit të lëshuar nga banka në emër të subjektit. Vlera: 149,723 lekë.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: të krijuara nga paga, të ardhurat e tjera dhe qiratë.

<sup>23</sup> Subjekti ka vënë në dispozicion: (i) certifikatë pronësie datë 22.4.2005, për pasurinë arë + truall sip. totale 2000 m<sup>2</sup> dhe sip. truall 300 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 100 m<sup>2</sup>, në emër të z. Z. M. (ii) certifikatë pronësie, datë 22.4.2005, për pasurinë arë me sip. 13.000 m<sup>2</sup>, në emër të z. Z. M., + harta treguese.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme.

<sup>25</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vërtetim datë 17.1.2017 dhe 25.1.2017, nga “ProCredit Bank”, praktika e mbylljes së llogarive dhe nxjerrje llogarie; (ii) vërtetim për të ardhurat nga depozita, datë 25.10.2016, si dhe nxjerrje llogarie; (iii) vërtetim për të ardhura nga depozita në “ProCredit Bank”, datë 25.10.2016; (iv) nxjerrje llogarie “ProCredit Bank”; (v) nxjerrje llogarie “ProCredit Bank”, në emër të z. D. G.

**41. Depozitë në “ProCredit Bank” në emër të djalit të subjektit A. G. Vlera: 183,386 lekë.**

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: krijuar nga të ardhurat e familjes, interesat e bankës duke filluar nga data 10.7.2006, dhe në vijim.

**42. Zero depozitë aktuale në “ProCredit Bank” të mbyllur nga të cilat totali i interesit të gjeneruar janë interesa të përfituara ndër vite. Vlera: 259,000 lekë. Zotërimi: 50 %.**

**43. Llogari bankare në “ProCredit Bank” në emër të djalit të subjektit D. G. Llogari rrjedhese: me zero fonde. Llogari kursimi me gjendje: 4.65 lekë.**

**44. Depozitë me afat hapur në datën 17.1.2007 dhe në vijim në “ProCredit Bank” në emër të djalit të subjektit D. G. Vlera: 344,186 lekë, nga të cilat ka përfituar interesa ndër vite në vlerën 60.600 lekë.**

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: burimi janë të ardhurat e familjes nga paga, qiratë dhe tërheqje fondi nga llogaria në “Raiffeisen Bank”.

### **Rezultati i hetimit<sup>26</sup>**

**45. Bazuar në shkresën e “ProCredit Bank” rezulton se:**

**45.1.1** Subjekti i rivlerësimit ka:

- i. llogari rrjedhëse me gjendje në vlerën 28,419.53 lekë e cila është mbyllur në datën 18.1.2017;
- ii. llogari kursimi me gjendje në vlerën 11,555.76 lekë e cila është mbyllur në datën 18.1.2017.

**45.1.2** Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka llogari kursimi, me gjendje në vlerën 499.61 lekë, e cila është mbyllur në datën 19.1.2017. Nga nxjerrja e llogarisë rezulton se:

- i. Në datën 16.6.2010, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në “ProCredit Bank” shumën 500,500 lekë, *cash*. Nga analiza financiare më poshtë rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të bërë këtë depozitim.
- ii. Në datën 30.10.2010, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka depozituar në “ProCredit Bank” shumën 1,500,000 lekë, *cash*, me emërtesë të ardhura nga paga për pagesë ALUZINI-t. Nga analiza financiare, si më poshtë, Komisionit i ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të depozituar shumën 1,500,000 lekë.

	deri më 16.6.2010	16.6.2010 – 30.10.2010	1.1.2010 – 30.10.2010
<b>Të ardhurat</b>	<b>1 022 166</b>	<b>1 084 776</b>	<b>2 106 942</b>
D. G.	570 505	750 082	1 320 587
Alkelina Gazidedja	451 660	334 694	786 354
<b>Shpenzimet</b>	<b>250 470</b>	<b>204 930</b>	<b>455 400</b>
<b>Likuiditet krijuar deri më 30.10.2010</b>	<b>600 500</b>	<b>1 957 900</b>	<b>2 558 400</b>
<i>Cash</i> te “ProCredit Bank” subjekti më 19.1.2010	100 000		100 000
<i>Cash</i> te “ProCredit Bank” bashkëshorti më 16.6.2010	500 500		500 500

<sup>26</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.

Depozite me afat te BKT, më 6.8.2010		457 900	457 900
Cash te "ProCredit Bank" bashkëshorti, më 30.10.2010		1 500 000	1 500 000
<b>Teprica të mundshme për kursim</b>	<b>171 196</b>	<b>-1 078 054</b>	<b>-906 858</b>

**45.1.2.1** Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje mungesën e të ardhurave për krijimin e depozitës në shumën 1,500,000 lekë.

**45.1.2.2** Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, shpjegoi se në vitin 2010 është bërë pagesa e vlerës së truallit. Siç del nga aktet shkresore që ka dorëzuar subjekti, por edhe të administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trualli është në bashkëpronësi të shtetasve D., dhe A. G., pagesa e truallit dhe detyrimeve të tjera, janë bërë nga at e bir. Në këto kushte, subjekti ka pretenduar se nuk mundet që kjo vlerë të ngarkohet vetëm në të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, pra, asaj për sa kohë trualli është në bashkëpronësi. Për këtë arsye ka kërkuar që të bëhet rishikimi i analizës financiare, duke marrë në konsideratë kontributin e familjes së vjehrrit për blerjen e truallit.

**45.1.2.3** Subjekti kërkoj që vlera e mundësisë së kursimit të vitit 2009, e cila është në vlerën 2,300,000 lekë e nxjerrë prej Komisionit në analizën financiare, justifikon plotësisht blerjen e truallit në vitin 2010. Gjithashtu, subjekti kërkoj që të ardhurat nga qiraja në vitin 2010 në vlerën 400,000 lekë duhet të merreshin në konsideratë pasi ka paguar detyrimet tatimore.

**45.1.2.4** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vendosi të përfshinte në analizën financiare të ardhurat nga qiraja për vitin 2010 ( shihni pikën 34.8.1 të këtij vendimi), shumën prej 1,280,000 lekësh (shihni pikën 33.5.5-33.5.7 të këtij vendimi), si dhe të ardhurat/interesat bankare/likuiditetet e vjehrrit dhe vjehrrës duke qenë se trualli është blerë nga bashkëshorti i subjektit dhe babai i tij (shihni pikën 34.8.1 të këtij vendimi).

**45.1.2.5** Pas përfshirjes së të ardhurave të mësipërme nga analiza financiare konstatohet se bashkëshorti i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të depozituar shumën prej 1,500,000 lekësh.

	<b>2010</b>
<b>PASURI</b>	<b>2 084 407</b>
Trualli për banesën 3-katëshe, sip. 437.60 m <sup>2</sup> , Rr. "***", Tiranë	1 989 510
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	94 897
Likuiditete gjendje	3 807 829
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>3 734 654</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	985 441
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 752 894
Të ardhura nga A. G., (babai b/shortit)	533 316
Interesa nga bankat	63 003
Të ardhura nga qiraja	400 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 086 393</b>
Shpenzime jetese	683 100
Shpenzime për legalizim të ndërtesës 3-katëshe	103 293
Shpenzime të tjera (te evidentuara)	300 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>563 855</b>

**45.1.3** Djali i subjektit të rivlerësimit, z. A. G., ka llogari kursimi me gjendje në vlerën 183,386.09 lekë

**45.1.4** Djali i subjektit të rivlerësimit, z. D. G., ka: (i) depozitë me afat me gjendje në vlerën 344,186.25 lekë; (ii) llogari rrjedhëse e cila nuk ka fonde; dhe (iii) llogari kursimi me gjendje në vlerën 4.65 lekë.

**45.1.5** Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këto llogari.

**46. Gjendje në llogari**<sup>27</sup> të ardhurat nga pagat në “Raiffeisen Bank”, në emër të deklarueses. Vlera: 799.432 lekë.

**47. “Raiffeisen Bank”**, hapur depozita në datën 6.5.2005 dhe e mbyllur llogaria në datën 30.12.2016. Në shumën 57,366 lekë, depozitë e tërhequr, nga të cilat janë fituar interesa në vlerën 2,218 lekë.

**48. “Raiffeisen Bank”, gjendje në llogari rrjedhëse e bashkëshortit.** Vlera: 1,360,829 lekë.

Llogari rrjedhëse si Person Fizik në “Raiffeisen Bank”. Vlera: 1,058 lekë. Zotërimi: 50 %.

## **Rezultati i hetimit**<sup>28</sup>

**48.1** Bazuar në shkresën e “Raiffeisen Bank” rezulton se:

**48.1.1** Subjekti i rivlerësimit ka llogari page në këtë bankë. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezulton se subjekti i rivlerësimit ka gjendje 799,432.16 lekë deri në datën 16.1.2017. Kjo shumë është krijuar nga kursimi i pagave që kalojnë te “Raiffeisen Bank” gjatë vitit 2016 dhe janarit të 2017. Për sa i takon mundësisë së subjektit për të kursyer këto paga, shihni analizën e vitit 2016 më poshtë.

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar këtë shumë.

**48.1.2** Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka:

**a.** Llogari në lekë me gjendje 1,360,829.51 lekë në datën 23.1.2017.

Fillimisht kjo llogari ka pasur gjendje 700,000 lekë, të krijuara gjatë vitit 2014 nga paga gjendje në “Raiffeisen Bank” dhe nga depozitime gjatë vitit. Në vitin 2015 është shtuar shuma 100,000 lekë me burim nga të ardhurat nga paga gjatë vitit 2015, gjendje në bankë. Në datën 21.10.2016 është depozituar shuma 500, 000 lekë.

Mundësia financiare për krijimin e kësaj depozite dhe të shtesave të saj, pasqyrohen në tabelën më poshtë.

	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>1 944 028</b>	<b>1 143 450</b>	<b>2 761 387</b>
Automjet “Fiat Punto”, ***			
Automjet “Peugeot” ***	270 000		
Shtesa/Pakësime/ Likuiditete	1 674 028	1 143 450	2 761 387

<sup>27</sup> Subjekti ka dorëzuar dokumentet: (i) nxjerrje llogarie, datë 26.1.2017, në emër të znj. Alkelina Gazidedja, gjendja 799.432 lekë; (ii) nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, në emër të z. A. G., vlera 57,366 lekë është tërhequr në datën 30.12.2016; (iii) nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, datë 24.1.2017; (iv) nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, datë 27.1.2017.

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.

Likuiditete Gjendje	5 026 740	6 170 190	8 931 577
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>3 452 366</b>	<b>4 301 365</b>	<b>4 806 877</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 303 155	1 298 903	1 322 186
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	989 294	900 000	24 057
Të ardhura bashkëshorti nga biznesi	0	716 190	2 810 485
Interesa nga bankat	70 107	145 972	108 514
Të ardhura nga qiraja e banesës	86 400	141 100	168 000
Të ardhura nga qiraja e dyqanit	348 000	270 300	306 000
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor për, D. G.	643 410		
Përfiturar fëmijët për rezultate në shkolle	12 000	3 000	0
Të ardhura nga shitja e automjetit		825 900	
Të ardhura djali nga biznesi			<b>67 635</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 472 136</b>	<b>1 279 126</b>	<b>2 013 612</b>
Shpenzime jetese	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi TIMS	58 846	42 139	79 230
Shpenzime mobilimi (sipas P. 2)	210 000	210 000	
Shpenzime doganore për automjetet	71 100		
Shpenzime për hapjen e biznesit të djalit			501 202
Shpenzime shkollimi	252 198	129 883	485 516
Shpenzime të tjera (të evidentuara)			7 296
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>36 202</b>	<b>1 878 790</b>	<b>31 877</b>

b. Llogari në lekë për investim në Bono Thesari me datë investimi 5.7.2018 – 4.7.2019, shuma e investuar 450,000 lekë

Kjo shumë rezulton të jetë depozituar nga znj. M. S., në datën 29.6.2018 në po të njëjtën datë bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga llogaria e mësipërme i ka kaluar znj. M. S., shumën 450,000 lekë.

Në lidhje me këtë transferim subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të parë sqaron se:

*“Bashkëshorti D. G., është klient i ‘Raiffeisen Bank’, dhe në datën 29.6.2018 ka depozituar cash shumën 450,000 lekë e investuar në bono thesari. Nuk ka kryer asnjë veprim/transaksion me shtetasen M. S. Nga informacioni i kërkuar pranë bankës në lidhje me këtë shtetase, morëm përgjigjen e datës 16.7.2019 me nr. \*\*\* dhe atë të datës 19.7.2019 me nr. \*\*\* prot, sipas të cilit rezulton se M. S., më herët ka qenë kliente e kësaj banke. Numri personal dhe numri i llogarisë së kësaj shtetaseje (pasi ajo i ka mbyllur ato) i janë alokuar në mënyrë rastësore bashkëshortit tim kur ai është bërë klient i kësaj banke. Banka konfirmon faktin se veprimi i datës 29.6.2018 është kalim midis llogarive të z. G., dhe ky veprim nuk ka asnjë lidhje me znj. S. Dokumenti provues, shkresa e datës 16.07.2019 me nr. \*\*\* prot., shkresa e datës 19.7.2019 me nr. \*\*\* prot., lëvizjet e llogarive me nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*, të nxjerra nga sistemi i bankës në datë 19.09.2019...”*

Subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\*, datë 16.7.2019, të “Raiffeisen Bank” e cila sqaron se numri personal dhe numri i llogarive që ka në përdorim z. D. G., më parë i përkisnin znj. M. S., duke konfirmuar se veprimi i datës 29.6.2018 nuk ka asnjë lidhje me zj. M. S. Ky fakt konfirmohet dhe nga shkresa tjetër me nr. \*\*\*prot., datë 19.7.2019, të “Raiffeisen Bank”.

c. Llogari si Person Fizik me NIPT \*\*\*

Llogaria është çelur në datë 15.07.2016 me depozitim e shumës 57,000 lekë dhe është mbyllur në datë 24.5.2017. Llogaria është përdorur për pagesën e detyrimeve të PF ndaj organeve

tatimore. Gjendja e kësaj llogarie në 31.12.2016 është 1 428.03 lekë, e cila është përfshirë në analizën financiare të subjektit.

Mundësia financiare e subjektit pasqyrohet në analizën e vitit 2016.

**48.1.3 Z. A. G.**, ka pasur llogari në këtë bankë. Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së depozitës në “Raiffeisen Bank” rezulton se në datën 6.5.2006 është hapur llogari me gjendje 55,148.41 lekë në emër të z. A. G. Kjo llogari është mbyllur në datën 30.12.2016 duke u tërhequr dhe shuma 57,366.68 lekë.

**48.2** Në përfundim të hetimit, pasi analizoi të gjitha provat e administruara nëpërmjet hetimit administrativ, si dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, Komisioni nuk konstaton paqartësi apo pamjaftueshmëri në lidhje me këto llogari/depozita bankare.

**49. “Credins Bank” hapur/fillon akumulimin**, në datën 20.2.2015, transferim nga llogaria e bankës tjetër e në vijim. Shuma 3,639,156 lekë, nga të cilat totali i interesit të gjeneruar është 72.380 lekë.

**50. “Credins Bank”<sup>29</sup> hapur/fillon akumulimin**, në datën 22.2.2016 dhe në vijim. Shuma 1,000,200 lekë nga të cilat totali i interesit të gjeneruar është 3,206 lekë.

### Rezultati i hetimit<sup>30</sup>

**50.1** Bazuar në shkresën e “Credins Bank” rezulton se z. D. G., ka depozitë me gjendje aktive 3,639,156.02. Lekë dhe depozitë me gjendje aktive 1,000,200 lekë. Shumat e mësipërme janë krijuar, si më poshtë:

- Shuma prej 3,227,790 lekësh si *maturim* i depozitës 3,155,000 lekë, transferuar nga “ProCredit Bank” në “Credins Bank” në datën 18.2.2015. Kjo shumë është krijuar gjatë viteve 2013 dhe 2014 në “ProCredit Bank”.
- Shuma prej 411,366 lekësh, depozitë me afat çelur në datën 3.7.2014, me burim shumën 643,410, depozituar në “Credins Bank” në datën 24.6.2014, si ekzekutim i vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 18.6.2012 për D. G.
- Shuma 1,000,200 lekë është krijuar gjatë vitit 2016 nga kursimi i pagave që kalojnë në “Credins Bank” dhe nga depozitime.

### Analizë financiare (në lekë)

	2013	2014	2015	2016
<b>PASURI</b>	<b>-651 637</b>	<b>1 944 028</b>	<b>1 143 450</b>	<b>2 761 387</b>
Automjet “Fiat Punto” ***				
Automjet “Peugeot” ***		270 000		
Shtesa/Pakësime/ Likuiditete	-651 637	1 674 028	1 143 450	2 761 387
Likuiditete gjendje	3 352 712	5 026 740	6 170 190	8 931 577
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>2 723 525</b>	<b>3 452 366</b>	<b>4 301 365</b>	<b>4 806 877</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 005 777	1 303 155	1 298 903	1 322 186
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 064 627	989 294	900 000	24 057
Të ardhura bashkëshorti nga biznesi	53 079	0	716 190	2 810 485

<sup>29</sup> Subjekti ka dorëzuar dokumentet: (i) vërtetim nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, nga “Credins Bank”; (ii) nxjerrje llogarie “Credins Bank”, në emër të z. D. G.

<sup>30</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.

Interesa nga bankat	75 893	70 107	145 972	108 514
Të ardhura nga qiraja e banesës	0	86 400	141 100	168 000
Të ardhura nga qiraja e dyqanit	36 000	348 000	270 300	306 000
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor për D. G.		643 410		
Paguar dieta nga ***	88 149			
Përfiturar fëmijët për rezultate ne shkolle	0	12 000	3 000	0
Të ardhura nga shitja e makinës	400 000		825 900	
Të ardhura djali nga biznesi				<b>67 635</b>
<b>SHPENZIME</b>	<b>2 848 666</b>	<b>1 472 136</b>	<b>1 279 126</b>	<b>2 013 612</b>
Shpenzime jetese	564 096	879 992	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	207 462	58 846	42 139	79 230
Shpenzime mobilimi (sipas P. 2)		210 000	210 000	
Shlyer huaja te kunata B. M.	1 800 000			
Shpenzime doganore për automjetet		71 100		
Shpenzime për hapjen e biznesit te djalit				501 202
Shpenzime shkollimi	266 399	252 198	129 883	485 516
Shpenzime të tjera (të evidentuara)	10 709			7 296
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>526 496</b>	<b>36 202</b>	<b>1 878 790</b>	<b>31 877</b>

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e likuiditeteve të mësipërme. Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e administruar.

**51. “Raiffeisen Invest”<sup>31</sup>, zero depozitë aktuale**, mbyllur depozitat, e ndër vite/depozita e kaluar në llogarinë rrjedhëse në po këtë bankë nga të cilat totali i interesit të gjeneruar ndër vite është në vlerën 100,790 lekë.

### Rezultati i hetimit<sup>32</sup>

**51.1** Gjatë hetimit administrativ, “Raiffeisen Invest” informon se z. D. G., është investitor në “Fondin Raiffeisen Prestigj” me gjendje llogarie në datën 8.1.2019, në vlerën 442,839.02 lekë

**51.2** Bazuar në vërtetimin mbi pasqyrën e llogarisë në datën 8.1.2019 të “Raiffeisen Invest” rezultojnë lëvizjet mëposhtme:

Data	Përshkrimi	Vlera	Nr. i kuotave	Fitimi	Tatimi
27.12.2012	Blerje	1,600,000	1,507.7561		
18.4.2013	Shlyerje	1,637,437.6	1,507.7561	37,437.6	3 743.76
6.8.2014	Blerje	300,000	253.4560		
15.9.2014	Blerje	100,000	84.0378		
14.10.2014	Blerje	100,000	83.7052		
14.11.2014	Blerje	100,000	83.3434		
10.12.2014	Blerje	100,000	83.0480		
15.1.2015	Blerje	100,000	82.6567		
13.11.2015	Shlyerje	850,717.03	670,2471	50,716.96	7,607.54
1.4.2016	Blerje	837,000	629,5767		
20.9.2016	Tërheqje	865,220.08	629,5767	28,220.02	4,233
7.2.2017	Blerje	1,360,800	982,2121		
13.11.2017	Shlyerje	1,408,121.86	982,2121	47,321.9	7,098.29

<sup>31</sup> Subjekti ka dorëzuar dokumentet: (i) pasqyrë llogarie, datë 2.11.2016 dhe 23.1.2017, nga “Raiffeisen Invest”; (ii) nxjerrje llogarie për datat 9.1.2017 dhe 23.1.2017; (iii) depozitim në llogari personale datë 21.10.2016.

<sup>32</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.

23.1.2018	Blerje	423,360	295,9206		
-----------	--------	---------	----------	--	--

**51.3** Në lidhje me veprimet e kryera në vitin 2014 nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar likuiditetet dhe blerjet e pasurive të luajtshme në shumën 775,344 lekë.

	<b>2014</b>
<b>PASURI</b>	<b>1 944 028</b>
Automjet “Peugeot” *** , në emër të djalit D.	270 000
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	1 674 028
Likuiditete gjendje	5 026 740
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>2 665 821</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 303 155
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	469 749
Të ardhura nga qiraja	167 400
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor nr. ***, datë 18.6.2012, për D. G.	643 410
Interesa nga bankat	70 107
Përfiturar fëmijët për rezultate ne shkolle	12 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 497 136</b>
Shpenzime jetese	879 992
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	58 846
Shpenzime mobilimi (sipas P.2)	210 000
Shpenzime doganore për automjetet	71 100
Shpenzime shkollimi	277 198
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-775 344</b>

**51.4** Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës në lidhje mungesën e të ardhurave të mjaftueshme në shumën 775,344 lekë për të krijuar likuiditetet dhe blerjen e pasurive të luajtshme në vitin 2014.

**51.5** Subjekti pas kalimit të barrës së provës prapësoi se nga Komisioni nuk janë llogaritur pagat, që bashkëshorti i saj ka përfiturar gjatë kohës që ka qenë i punësuar pranë kompanisë “\*\*\*\*” (\*\*\*) për periudhën qershor 2014 – 31.12.2014 me NIPT \*\*\*. Sikundër provohet nga aktet shkresore, vërtetimet e lëshuara dhe *old statement* të lëshuara nga “Raiffeisen Bank”, bashkëshortit i është kaluar paga e muajit qershor në vlerën 69.545 lekë dhe më pas paga në muajin korrik, gusht, shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor në vlerën 90.000 lekë në muaj. Nga shkresa kthim përgjigjeje e Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, vërtetimi i \*\*\*. provohet se bashkëshorti i saj ka përfiturar pagën nga \*\*\*. Për vitin 2014 subjekti ka pretenduar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë dhe të njohë të ardhurat të ligjshme nga qiraja në shumën 296,667 lekë (përves të ardhurave të njohura në analizën financiare).

**51.6** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjektit, vlerëson se në analizën e vitit 2014 duhet të përfshihen: (i) të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga shoqëria \*\*\*. Këto të ardhura vërtetohen nga nxjerrja e llogarisë e z. D. G., në “Raiffeisen Bank”, nga ku rezulton se shoqëria \*\*\* ka transferuar shumat, si më poshtë:



Data	Shuma/lekë
23.7.2014	69,708
1.8.2014	90,000
29.8.2014	90,000
10.10.2014	90,000
30.10.2014	90,000
27.11.2014	90,000
<b>TOTAL</b>	<b>519,708</b>

Këto të ardhura konfirmohen dhe nga ekstrakti historik i punonjësit nxjerrë nga sistemi i DPT-së, vërtetimi nr. \*\*\*, datë 22.11.2019, i shoqërisë \*\*\*, si dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017 e ISSH-së, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së; (ii) të ardhurat e përfituara nga qiraja, për të cilat subjektit ka depozituar dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore, konkretisht, vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, lëshuar nga DRT-ja Tiranë.

**51.7** Pas propësimeve të subjektit, si dhe vlerësimit të fakteve të dokumentuara, rezulton se analiza financiare e subjektit për vitin 2014, paraqitet si më poshtë:

	2014
<b>PASURI</b>	<b>1 944 028</b>
Automjet tip "Peugeot" ***	270 000
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	1 674 028
Likuiditete gjendje	5 026 740
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>3 452 366</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 303 155
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	989 294
Interesa nga bankat	70 107
Të ardhura nga qiraja e banesës	86 400
Të ardhura nga qiraja e dyqanit	348 000
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor për D. G.	643 410
Përfituar fëmijët për rezultate në shkollë	12 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 472 136</b>
Shpenzime jetese	879 992
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	58 846
Shpenzime mobilimi (sipas pyetësorit nr. 2)	210 000
Shpenzime doganore për automjetet	71 100
Shpenzime shkollimi	252 198
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>36 202</b>

**51.8** Pas përfshirjeve të këtyre të ardhurave rezultati financiar për vitin 2014 rezulton pozitiv, duke krijuar bindjen te Komisioni se subjekti nuk ka qenë në kushtet e pamundësisë financiare.

**52. "Tirana Bank"**<sup>33</sup>, krijuar nga të ardhurat e prindërve të deklarueses z. Z. M., dhe znj. N. M., si dhe interesat që ka gjeneruar depozita nga data 11.1.2005 dhe në vijim. Vlera prej 223,809 lekësh, nga të cilat totali i interesit është 67,677 lekë.

<sup>33</sup> Subjekti ka dorëzuar dokumentet: (i) konfirm bankar datë 20.1.2017, në emër të z. A. G., në vlerën 223.809 lekë + mandatderdhje *cash* nga znj. N. M., + certifikatë depozite + nxjerrje llogarie "Tirana Bank", ku konfirmohen të ardhurat nga interesat; (ii) konfirm bankar nr. \*\*\*, datë 21.10.2016; (iii) nxjerrje llogarie në emër të z. D. G.

**53. “Tirana Bank”, zero depozitë aktuale**, mbyllur depozitimet ndër vite, nga të cilat totali i interesit të gjeneruar është 215.992 lekë. Zotërimi: 50 %.

### Rezultati i hetimit<sup>34</sup>

**53.1** Bazuar në shkresën e “Tirana Bank” rezulton se djali i subjektit të rivlerësimit, z. A. G., ka depozitë Junior në këtë bankë me balancë në vlerën 223,809 lekë.

**53.2** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në “Tirana Bank” rezulton se:

- i. shuma prej 639,190 lekësh është krijuar gjatë vitit 2007 nga kursimet e pagave që kalojnë në llogarinë e “Tirana Bank” dhe nga 8 depozitime të kryera gjatë vitit. Kjo shumë mbartet edhe në vitin 2008;
- ii. duke filluar nga shkurti i vitit 2008, kryhen nga D. G., 8 depozita *cash* me shumë totale 582,000 lekë. Çdo shumë e depozituar gjatë vitit 2008 është investuar në depozita afatshkurtra, në të njëjtën datë të depozitimit *cash*.
- iii. Në datën 11.2.2009 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka tërhequr *cash* shumën 1,281,000 lekë, e cila është *maturim* i depozitës me afat.

### 53.3 Analizë financiare (në lekë)

	2007	2008
<b>PASURI</b>	<b>1 660 660</b>	<b>1 629 658</b>
Aksione në shoqërinë “****”		200 000
Automjet tip “Mercedes Benz” ***		862 278
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	1 660 660	567 380
Likuiditete gjendje	2 326 676	2 894 056
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>2 697 248</b>	<b>2 674 868</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	866 609	870 011
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 252 955	1 104 555
Të ardhura nga A. G., (babai i bashkëshortit)	395 307	431 076
Interesa nga bankat	2 377	89 226
Të ardhura nga qiraja e banesës	180 000	180 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>851 720</b>	<b>804 084</b>
Shpenzime jetese	683 100	683 100
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	68 620	6 984
Shpenzime mobilimi (sipas P.2)	100 000	110 000
Shpenzime për legalizim të ndërtesës 3-katëshe		4 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>184 867</b>	<b>241 126</b>

**53.4** Në përfundim të hetimit, Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë e saktë në deklaratimet e saj dhe ka pasur mundësi financiare.

**54. BKT-ja<sup>35</sup>, zero depozitë aktuale**, mbyllur depozitimet ndër vite, nga të cilat totali i interesit të gjeneruar është 11,177 lekë. Zotërimi: 50 %.

<sup>34</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018 drejtuar bankave.

<sup>35</sup> Subjekti ka dorëzuar: nxjerrje llogarie në BKT, datë 24.10.2016, në emër të D. G.

## Rezultati i hetimit<sup>36</sup>

### 54.1 Nga nxjerrja e llogarisë në BKT rezulton se:

Znj. K. K., ka tërhequr pagën për z. D. G., si më poshtë:

- gjatë vitit 2008 janë bërë 11 tërheqje, në shumën 793,117 lekë;
- gjatë vitit 2009 janë bërë 17 tërheqje, në shumën 1,281,592 lekë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka sqaruar se bashkëshorti ka qenë drejtor Rajoni Tiranë 2 në shoqërinë “\*\*\*” sh.a., për periudhën 5.12.2005 – 28.8.2006, me pas është transferuar drejtor Rajoni Tirana 1 për periudhën 29.8.2006 – 17.9.2009, sikundër provohet nga përmbajtja e librezës së punës datë 10.4.1998, lëshuar nga filiali \*\*\* Tiranë. Shtetasja K. K., ka qenë sekretare e bashkëshortit në kohën që ai ka ushtruar detyrën e drejtorit Rajoni Tirana 1 në shoqërinë “\*\*\*” sh.a.

Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacion provues<sup>37</sup>, duke shpjeguar marrëdhënien e krijuar midis znj. K. K., dhe bashkëshortit të saj.

Komisioni, në përfundim të hetimit, vlerëson se subjekti ka qenë e saktë në deklaratimet e saj.

Subjekti i rivlerësimit si burim për të gjitha llogaritë bankare të mësipërme ka deklaruar:

Krijuar nga të ardhurat e familjes ndër vite, nga puna në shtet dhe privat, qiratë e dyqanit dhe banesës, interesat e bankave respektive për çdo depozitë, nga ekzekutimi i vendimeve gjyqësore nr. \*\*\*, datë 8.11.2011 dhe nr. \*\*\*, datë 18.6.2012, si dhe nga shitja e automjeteve. Vlerat janë bazuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga bankat respektive.

### 55. Gjendje *cash* në banesë, vlera 1,500,000 lekë.

55.1 Në fund të vitit 2016 subjekti deklaroi *cash* gjendjen 1,400,000 lekë, ndërkohë në deklaratën “Vetting” deklaroi se ka gjendje *cash* shumën prej 1,500,000 lekësh.

Nga analiza financiare e mëposhtme për vitin 2016 rezulton:

	2016
<b>PASURI</b>	<b>2 759 959</b>
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	2 759 959
Likuiditete gjendje	<b>8 930 149</b>
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>4 614 820</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 322 186
Të ardhura bashkëshorti nga biznesi	2 810 485
Interesa nga bankat	108 514
Të ardhura nga qiraja	306 000
Të ardhura të tjera	67 635
<b>SHPENZIME</b>	<b>2 046 685</b>
Shpenzime jetese	940 368
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	73 819
Shpenzime për hapjen e biznesit të djalit	501 202
Shpenzime shkollimi	524 000

<sup>36</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave të nivelit të dytë.

<sup>37</sup> Vërtetim datë 22.7.2019, me nr. \*\*\* sipas së cilës provohet se shtetasja K. K., ka ushtruar detyrën sekretare e Drejtorit të Rajonit Tirana 1 nga data 22.12.2005 – 31.7.2011.

Shpenzime të tjera (të evidentuara)	7 296
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-191 825</b>

Nga analiza konstatohet se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar kursimet *cash*, duke i kaluar barrën e provës.

**55.2** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka shpjeguar se Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë në llogaritjet e tij: (i) të ardhurat nga qiratë, fakt i gjendjes së të ardhurave nga viti 2015; (ii) shitjen e automjetit në vlerën 6,000 euro në vitin 2015, sikundër provohet nga kontrata e shitjes së automjetit datë 16.4.2015; (iii) përfshirjen e tarifave të shkollimit të djalit dhe bashkëshortit dy herë, në shpenzimet e jetesës dhe si shpenzime më vete, duke pasur parasysh faktin se shkolla ka qenë publike; (iv) Komisioni nuk ka njohur si të ardhura vlerën 500 euro punë të kryer nga djali D., *online*, punë e cila është paguar me “AK INVEST” “MoneyGram” me nr. \*\*\*, datë 28.12.2016; (v) nga Komisioni nuk është njohur vlera e përfituar nga dhënia me qira e një pjese të banesës me argumentin se nuk janë paguar tatimet në burim, ndërkohë që subjekti kërkon që të përfshihet në analizë shuma prej 168,000 lekësh, nga të ardhurat nga qiraja duke qenë se vërtetohet pagimi i tatimit në burim me vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, të DRT-së Tiranë.

**55.3** Subjekti, në parashtrimet e saj, ka pretenduar se bilanci i vitit 2015 është pozitiv në një vlerë të konsiderueshme, për këtë arsye vlerat që dalin si mundësi kursimi të merren në konsideratë si gjendje të ardhurash të ligjshme në banesë, pavarësisht se nuk janë deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit.

**55.4** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e depozituara, vlerëson se mundësitë për kursim të subjektit, ndër vitet, nuk mund të përfshihen në analizë financiare, pasi subjektet kanë pasur detyrimin që në fund të çdo viti të deklaronin pakësimet dhe shtesat në DPV. Nga subjekti nuk rezulton që në fund të çdo viti të jenë deklaruar kursime *cash*, me përjashtim të çeljeve dhe mbylljeve të depozitave në bankat e nivelit të dytë.

**55.5** Nga hetimi rezulton se subjekti ka shitur një automjet në datën 16.4.2015, në shumën 6,000 euro, si dhe viti 2015 rezulton me mundësi kursimi në shumën 797,530 lekë, por për sa kohë nuk ka deklaruar kursime *cash* nuk mund të merret në konsideratë.

**55.6** Ndërkohë, Komisioni ka marrë në konsideratë të ardhurat nga qiraja, pasi është vërtetuar pagimi i detyrimeve tatimore, si dhe shpenzimet e shkollimit janë reduktuar në masën që të përfshihen në shpenzimet e jetesës. Shpenzimet *TIMS* janë rillogaritur bazuar në dokumentacionin justifikues që ka sjellë subjekti.

**55.7** Komisioni ka bërë një analizë të re në lidhje me gjendjen *cash*:

	<b>2016</b>
<b>PASURI</b>	<b>2 761 387</b>
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	2 761 387
Likuiditete gjendje	8 931 577
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>4 806 877</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 322 186
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	24 057
Të ardhura bashkëshorti nga biznesi	2 810 485
Interesa nga bankat	108 514
Të ardhura nga qiraja e banesës	168 000
Të ardhura nga qiraja e dyqanit	306 000

Të ardhura djali nga biznesi	67 635
<b>SHPENZIME</b>	<b>2 013 612</b>
Shpenzime jetese	940 368
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	79 230
Shpenzime për hapjen e biznesit të djalit	501 202
Shpenzime shkollimi	485 516
Shpenzime të tjera (të evidentuara)	7 296
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>31 877</b>

Nga analiza financiare konstatohet se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen *cash*.

**56. Automjet tip “Peugeot”<sup>38</sup>**, me targa \*\*\*, në emër të djalit D. G., blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 15.8.2014. Vlera: 270,000 lekë. Zotërimi: 100 %.

Burimi sipas deklaratës “Vetting”: nga të ardhurat e familjes.

### Rezultati i hetimit<sup>39</sup>

**56.1** Në datën 25.8.2014, djali i subjektit të rivlerësimit, D. G., me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, ka blerë automjetin tip “Peugeot” me targa \*\*\*, në vlerën 270,000 lekë.

**56.2** Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera.

	2014
<b>PASURI</b>	<b>1 944 028</b>
Automjet tip “Peugeot” ***, në emër të djalit D.	270 000
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	1 674 028
Likuiditete gjendje	5 026 740
<b>TË ARDHURA të dokumentuara</b>	<b>2 665 821</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 303 155
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	469 749
Të ardhura nga qiraja	167 400
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor për D. G.	643 410
Interesa nga bankat	70 107
Përfituar fëmijët për rezultate në shkollë	12 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 497 136</b>
Shpenzime jetese	879 992
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	58 846
Shpenzime mobilimi (sipas P.2)	210 000

<sup>38</sup>Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 25.8.2014; (ii) vërtetim nr. \*\*\*, datë 20.10.2016, nga DPSHTRr-ja.

<sup>39</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbime të Transportit Rrugor; kthim-përgjigje DPSHTRr-ja me nr. \*\*\* prot., datë 4.1.2019.

Shpenzime doganore për automjetet	71 100
Shpenzime shkollimi	277 198
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-775 344</b>

Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit në lidhje me mungesën e të ardhurave për blerjen e automjetit.

**56.3** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegoi se: (i) të ardhurat e vitit 2014 nuk janë llogaritur drejt nga Komisioni, pasi nuk janë njohur pagat që bashkëshorti ka përfituar gjatë kohës që ka qenë i punësuar në kompaninë “\*\*\*\*” (\*\*\*\*), për periudhën qershor 2014 – 31.12.2014, me NIPT \*\*\*; (ii) subjekti kërkoi që t’i njihej edhe vlera e qirasë pasi ishin paguar detyrimet tatimore bazuar në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, të DRT-së Tiranë.

**56.4** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti, vlerëson se në analizën e vitit 2014 duhet të përfshihen:

- i. Të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nga shoqëria \*\*\*– këto të ardhura vërtetohen nga nxjerrja e llogarisë së z. D. G., në “Raiffeisen Bank”, si dhe konfirmohen nga ekstrakti historik i punonjësit nxjerrë nga sistemi i DPT-së, me vërtetimin nr. \*\*\*, datë 22.11.2019 dhe shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017, e ISSH-së, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.
- ii. Të ardhurat e përfituara nga qiraja, për të cilat subjekti ka depozituar dokumentacion provues për pagimin e detyrimeve tatimore, konkretisht, vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, lëshuar nga DRT-ja Tiranë.

**56.5** Pasi bëri këtë vlerësim të provave, njësia e shërbimit ligjor kreu analizën financiare, si më poshtë vijon:

	<b>2014</b>
<b>PASURI</b>	<b>1 944 028</b>
Automjet tip “Peugeot” ***	270 000
Shtesa/Pakësime/Likuiditete	1 674 028
Likuiditete gjendje	5 026 740
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>3 452 366</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 303 155
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	989 294
Interesa nga bankat	70 107
Të ardhura nga qiraja e banesës	86 400
Të ardhura nga qiraja e dyqanit	348 000
Ekzekutimi i vendimit gjyqësor për D. G.	643 410
Përfituar fëmijët për rezultate në shkollë	12 000
<b>SHPENZIME</b>	<b>1 472 136</b>
Shpenzime jetese	879 992
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	58 846
Shpenzime mobilimi (sipas pyetësorit 2)	210 000
Shpenzime doganore për automjetet	71 100
Shpenzime shkollimi	252 198
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>36 202</b>

**56.6** Pas përfshirjeve të këtyre të ardhurave rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit tip “Peugeot”. Subjekti ka qenë i saktë në deklaratën e saj në deklaratën “Vetting”.

**57. Biznes Person Fizik D. G<sup>40</sup>**, me NIPT \*\*\*, i regjistruar në datën 27.9.2016, blerë me faturë tatimore të thjeshtë nr. \*\*\*, datë 20.9.2016 dhe nr. \*\*\*, datë 20.9.2016, nga Personi Fizik E. M. Vlora: 450,180 lekë, blerja e biznesit. Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”: të ardhurat e familjes, nga paga, qiratë, shitje automjeti.

### Rezultati i hetimit<sup>41</sup>

**57.1** Subjekti ka depozituar faturë tatimore të thjeshtë nr. \*\*\*, datë 20.9.2016 dhe nr. \*\*\*, datë 20.9.2016, ku vërtetohet se djali i saj ka blerë pajisjet dhe aksesorët për aktivitetin tregtar të dhënies me qira të fustaneve për nuse.

**57.2** Në datën 29.9.2016 me kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, z. D. G., ka marrë me qira apartamentin me sip. 48.92 m<sup>2</sup>, për një periudhë njëvjeçare për ushtrimin e aktivitetit të tij. Vlera e qirasë: 25,000 lekë/muaj.

**57.3** QKB-ja konfirmojnë se z. D. G., figuron i regjistruar si Person Fizik, pajisur me NIPT: \*\*\*, regjistruar më 26.9.2016, me veprimtari “dhënie me qira të fustaneve për nuse dhe fustane të tjera, shitje me pakicë e tyre, etj.”, me status aktiv.

**57.4** Nga hetimi administrativ rezulton se djali i subjektit të rivlerësimit ka në pronësi apartamentin me sip. 48.92 m<sup>2</sup>, ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*. Ky apartament është blerë në datën 11.1.2018, me kontratën nr. \*\*\*, për shumën 8,001,942 lekë.

**57.4.1** Kësti i parë është likuiduar në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate nga llogaria e znj. Alkelina Gazidedja dhe z. D. G., në “Raiffeisen Bank” në shumën 4,000,000 lekë, vërtetuar kjo me dy transfertat e mëposhtme:

- i. në datën 11.1.2018, subjekti i rivlerësimit, nga llogaria në “Raiffeisen Bank” ka transferuar shumën prej 2,000,540 lekësh te notere F. Sh.;
- ii. në datën 11.1.2018, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, nga llogaria në “Raiffeisen Bank” ka transferuar shumën prej 2,000,660 lekësh, te notere F. Sh.

**57.4.2** Kësti i dytë, në shumën prej 4,001,942 lekësh duhet të likuidohet brenda datës 1.7.2018, nga llogaria bankare e z. D. G. Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit rezultojnë transferimet e mëposhtme në llogarinë e noterit publik F. Sh:

- i. në datën 4.4.2018, shuma 3,600,000 lekë;
- ii. në datën 27.4.2018, shuma 401,942 lekë.

**57.4.3** Burimi i deklaruar për këtë pasuri janë të ardhurat e krijuara nga prindërit si kursime familjare. Komisioni kreu analizën financiare për mundësitë e blerjes së këtij apartamenti në vitin 2018.

	2017	2018
<b>PASURI</b>	<b>2 674 316</b>	<b>86 873</b>
Apartament Rr. “****” Tiranë		8 001 942

<sup>40</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vërtetim nr. \*\*\*, datë 26.1.2016, nga DPT-ja; (ii) ekstrakt nga QKB-ja; (iii) fatura tatimore për blerje malli, nr. \*\*\* dhe \*\*\* vlera totale: 450,180 lekë; (iv) formular “MoneyGram”, nr. \*\*\*. (v) kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 29.9.2016.

<sup>41</sup>(i) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar QKB-së; (ii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; (iii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme; (iv) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.; (v) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar OSHEE-së; (vi) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave; (vii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar bankave; (viii) shkresë nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2019, drejtuar OSHEE-së.

Blerë aksione D., (shitur nga e ëma)	50 000	
Krijim i llogarisë Bitcoin	18 081	
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	2 606 235	-7 915 069
Likuiditete gjendje	11 537 812	3 622 743
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>5 314 626</b>	<b>5 138 076</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	1 349 890	1 374 707
Të ardhura nga paga e bashkëshortit		2 539 552
Të ardhura bashkëshorti nga biznesi	3 044 960	1 002 446
Të ardhura djali nga biznesi	606 500	
Interesa nga bankat	105 276	42 871
Të ardhura nga qiraja	153 000	178 500
Të ardhura të tjera	55 000	
<b>SHPENZIME</b>	<b>2 381 735</b>	<b>2 653 129</b>
Shpenzime jetese	862 004	705 276
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	241 718	109 576
Shpenzime shkollimi	1 278 013	1 838 277
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>258 575</b>	<b>2 398 074</b>

**57.4.4** Nga analiza financiare rezulton se djali i subjektit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij apartamenti. Komisionit nuk i lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Ky apartament nuk është i deklaruar në deklaratën “Vetting” sepse blerja e tij është bërë pas dorëzimit të kësaj deklarate.

## **58. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit<sup>42</sup>**

### **Rezultati i hetimit<sup>43</sup>**

**58.1** Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Nga hetimi rezultoi se të ardhurat e përfituara nga shoqëria \*\*\*, dhe ato të përfituara nga av. E. K., nuk konfirmohen nga ISSH-ja dhe në këto kushte nuk janë përfshirë në analizë financiare.

**58.1.1** Pas kalimit të barrës së provës, bazuar në shpjegimet dhe dokumentacionin e depozituar nga subjekti, rezulton se:

a) Të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga shoqëria \*\*\* vërtetohen nga nxjerrja e llogarisë së z. D. G., në “Raiffeisen Bank”, nga ku rezulton se kjo shoqëri ka transferuar shumat, si më poshtë vijon:

<b>Viti 2014</b>		<b>Viti 2015</b>	
Data	Shuma/lekë	Data	Shuma/lekë
23.7.2014	69,708	12.1.2015	90,000
1.8.2014	90,000	30.1.2015	90,000
29.8.2014	90,000	16.3.2015	90,000

<sup>42</sup>Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: (i) vërtetim nr.\*\*\* prot., datë 10.1.2017, nga SHISH-i; (ii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016, nga \*\*\*; (iii) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 4.11.2016, nga ALUIZNI, Tiranë; (iv) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 20.10.2016, nga \*\*\*; (v) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2016, nga \*\*\*; (vi) vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2016, nga shoqëria \*\*\*; (vii) vërtetim datë 23.1.2017, nga av. E. K.

<sup>43</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar QKB-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.6.2019, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore (arkivi).



10.10.2014	90,000	30.3.2015	90,000
30.10.2014	90,000	29.4.2015	90,000
27.11.2014	90,000	1.6.2015	90,000
		5.8.2015	180,000
		31.8.2015	90,000
		29.9.2015	90,000
<b>TOTAL</b>	<b>519,708</b>		<b>900,000</b>

Këto të ardhura konfirmohen edhe nga: (i) ekstrakti historik i punonjësit nxjerrë nga sistemi i DPT-së; (ii) vërtetimi nr. \*\*\*, datë 22.11.2019, nr. \*\*\*, datë 22.11.2019 i shoqërisë \*\*\*; si dhe (iii) shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017, e ISSH-së, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

b) Të ardhurat në shumën 24,057 lekë, të përfituara nga puna e bashkëshortit pranë av. E. K., konfirmohen nga ekstrakti historik i punonjësit D. G., printuar nga sistemi i DPT-së, nga ku rezulton që për periudhën 6.2015-11.2015 z. D. G., është siguruar nga av. E. K., dhe paguar prej tij vetëm për muajin tetor dhe nëntor me pagë minimale. Ky fakt konfirmohet edhe nga shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.7.2017, e ISSH-së, gjendur në dosjen e ILDKPKI-së.

**58.1.2** Komisioni vlerëson se në analizën financiare do të përfshihet shuma prej 24,057 lekësh, ndërkohë në lidhje me shumën 100,000 lekë, të përfituar si shpërblim, vlerëson se kjo shumë nuk do të përfshihet në analizën financiare, për sa kohë nuk provohet të jenë paguar detyrimet tatimore.

**58.1.3** Në përfundim, Komisioni vendosi të përfshijë të ardhurat e përfituara nga bashkëshorti i subjektit nga punësimi i tij në shoqërinë \*\*\*, si dhe të ardhurat nga av. E. K., në shumën prej 24,057 lekësh.

**58.2** QKB-ja konfirmon se z. D. G., figuron i regjistruar si:

**58.2.1** Person Fizik, pajisur me NIPT: \*\*\*, regjistruar në datën 7.11.2015, me aktivitet “Zyrë inxhinierike + juridike...” me status aktiv.

**58.2.1.1** Me shkresën nr. \*\*\*, datë 31.7.2019, nga DRT-ja Tiranë informohemi se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur këto të ardhura vjetore në formën e fitimit të tatueshëm:

Viti	Të ardhurat	Fitimi i tatueshëm	Fitimi
2015	858,233	774,260	716,190
2016	3,108,334	2,810,485	2,810,485
2017	3,503,003	3,044,960	3,044,960
2018	3,105,272	2,539,552	2,539,552

**58.2.2** Person Fizik, pajisur me NIPT \*\*\*, regjistruar në datën 10.7.2013, me veprimtari “Floktore”, status i çregjistruar, datë 28.3.2015. Adresa e deklaruar është ajo e dyqanit.

**58.2.2.1** Nga DRT-ja Tiranë nuk konfirmohen të ardhura për bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, por rezulton se ka deklaruar dhe paguar kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatim mbi pagën, sipas pasqyrës së mëposhtme:

Nr.	Periudha	Pagat	Kontribute Shoqërore	Kontribute Shëndetësore	Totali TAP	Nr. i punonjësve
1	2013 korrik	-	-	-	-	1
2	2013 gusht	20,308	4,975	690	-	1

3	2013 shtator	22,000	5,390	748	-	1
4	2013 tetor	22,000	5,390	748	-	1
5	2013 nëntor	9,310	2,281	317	-	1
<b>TOTALI</b>		<b>73 618</b>	<b>18 036</b>	<b>2 503</b>	-	<b>1</b>

**58.2.3** Person Fizik me NIPT \*\*\*, regjistruar në datën 19.1.2012, me veprimtari “Internet kafe”, me adresë: Qyteti Studenti, sheshi “\*\*\*\*”, statusi i çregjistruar, datë 21.6.2013.

**58.2.3.1** Nga DRT-ja nuk rezulton si veprimtari e regjistruar.

**58.3** Në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se bashkëshorti ka përfituar shumën prej 1,000,000 lekësh, për periudhën 1996 – 2005, si të ardhura nga puna *part time* si inxhinier elektrik në instalimet elektrike të banesave të reja në ndërtim.

**58.3.1** Për këto të ardhura nuk ka asnjë dokumentacion provues për marrjen e tyre, por dhe për pagimin e detyrimeve tatimore. Subjektit, pasi i është kërkuar dokumentacion, ka paraqitur tri deklarata dore në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit nga punime elektrike, si më poshtë:

- z. G. D., i cili deklaron se në vitin 1998 e ka paguar z. D. G., në shumën 80,000 lekë;
- z. A. S., i cili deklaron se në vitin 2001 e ka paguar z. D. G., në shumën 60,000 lekë;
- z. A. H., i cili deklaron se në vitin 1998 – 1999 e ka paguar z. D. G., në shumën 35,000 lekë.

**58.3.2** Këto deklarata nuk përbëjnë provë në kuptim të ligjit, pasi:

- nuk janë hartuar konform parashikimeve ligjore;
- nuk janë hartuar në momentin e kryerjes së veprimeve;
- nuk vërtetohet pagimi i tatimeve sipas detyrimit kushtetues.

**58.4** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti sqaroi se bashkëshorti ka ushtruar punë *part time* në projekte kontrata shërbimi për instalimet elektrike si banesa, vila etj. Subjekti ka paraqitur disa deklarata noteriale për të provuar punësimin e bashkëshortit *part time*, ndërsa për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore ka depozituar vërtetim nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet se z. D. G., si individ privat për tatimin mbi të ardhurat personale në bazë të formularit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për vitet 2011, 2012, 2014, 2015, 2016 (tatim qiraja dhe të ardhura *bruto* të tjera të papërmendura më lart), ka deklaruar të ardhurat, si më poshtë vijon:

Viti	Të ardhura <i>bruto</i> /lekë	Të ardhura <i>neto</i> /lekë
2011	3 240 000	324 000
2012	444 444	44 000
2014	296 667	29 667
2015	166 000	24 900
2016	197 647	29 647

**58.4.1** Komisioni vlerëson se të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga puna *part time* në shumën 600,000 lekë nuk do të përfshihen në analizë financiare, pasi nuk provohen me dokumentacion provues, ndërkohë për të ardhurat në vitet 2004 dhe 2005, për sa kohë rezulton se janë paguar detyrimet tatimore dhe janë deklaruar në DVP-të përkatëse, Komisioni vlerëson që të merren në konsideratë.

**59. Në lidhje me të ardhurat nga qiraja**

**KONSTATIMI I ILDKPKI-SË**

Mungon dokumentacioni justifikues ligjor, si kontrata qiraje etj., lidhur me dhënien me qira të shtëpisë së banimit, si dhe dokumentacioni i përfitimit të shumave të deklaruar për periudhën deri në vitin 2014, gjithashtu, nuk rezulton të jenë paguar detyrimet tatimore. Për periudhën 2014 – vazhdim, subjekti ka paraqitur kontratat e nënshkruara të qirasë, por rezulton se për këtë periudhë nuk janë paguar detyrimet tatimore.

**59.1** Në deklaratën “Vetting” subjekti deklaroi të ardhura nga dhënia me qira e dyqanit në shumën 1,085,500 lekë.

**59.1.1** Për të vërtetuar të ardhurat nga qiraja, subjekti ka depozituar:

- kontratë nr. \*\*\*, datë 16.11.2013;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 3.3.2014;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 8.1.2015;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 12.10.2015, znj. A. T.;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 30.3.2016;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 3.5.2017;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 3.1.2018;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 27.8.2018;
- kontratë nr. \*\*\*, datë 1.2.2019.

**59.1.2.** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit të parë, ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.8.2019, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, nga ku rezulton se janë kryer pagesat e mëposhtme për dyqanin e dhënë me qira:

Subjekti	NIPT	Lloji i Tatimit	Vlera e Tatueshme	Tatimi në Burim	Periudha
D. G.	***	Tatim në burim qira banese	96 000	9 600	2014
F. Rr.	***	Tatim në burim nga qiratë	30 000	3 000	2014
I. M.	***	Tatim në burim nga qiratë	60 000	6 000	2014
F. Rr.	***	Tatim në burim nga qiratë	240 000	36 000	2015
A. T.	***	Tatim në burim nga qiratë	78 000	11 700	2015
A. T.	***	Tatim në burim nga qiratë	60 000	9 000	2016
L. S.	***	Tatim në burim nga qiratë	300 000	45 000	2016
L. S.	***	Tatim në burim nga qiratë	40 000	6 000	2017
B. Sh.	***	Tatim në burim nga qiratë	140 000	21 000	2017
M. M.	***	Tatim në burim nga qiratë	210 000	31 500	2018
T. A.	***	Tatim në burim nga qiratë	90 000	13 500	2019

**59.1.3** Bazuar në shkresën e mësipërme, të ardhurat e realizuara nga qiraja janë përfshirë në analizën financiare si më poshtë, duke marrë në konsideratë pagesën e detyrimeve tatimore:

Të ardhura	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Të ardhura <i>neto</i> nga qiratë	167 400	270 300	306 000	153 000	178 500	76 500

**59.1.4** Në përfundim të hetimit, nga Komisioni u mor në konsideratë vetëm shuma 743,700 lekë, për të cilën provohej se ishin paguar detyrimet tatimore.

**59.1.5** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi se: *“Janë lidhur rregullisht kontratat e qirasë me personat, të cilët kanë marrë me qira ambientin duke përcaktuar qartësisht në kontratë detyrimin ligjor të pagimit të vlerës së tatimit mbi vlerën mujore të qirasë. Ky detyrim, me ligj, është përcaktuar se i takon qiramarrësit dhe jo qiradhënësit. Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar, germa ‘ë’, e nenit 33, të gjithë tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet duhet të dorëzojnë në Drejtorinë Rajonale Tatimore një kopje e kontratës së qirasë apo të kontratës së pronësisë së ambientit. Në zbatim të dispozitës ligjore të sipërpërmendur, tatimpaguesit që ushtrojnë aktivitet në ambientet e marra me qira duhet të llogaritin, mbajnë dhe derdhin për llogari të organeve tatimore tatimin në burim deri në datën 20 të muajit pasardhës të kryerjes së pagesës së qirasë. Detyrimin për të kryer pagesën e tatimit në burim sipas ligjit dhe udhëzimit e ka qiramarrësi, pra, ky tatim nuk kërkohet nga qiradhënësi”*. Subjekti ka depozituar në cilësinë e provës vërtetimin e pagimit nr. \*\*\*, datë 6.12.2019, nga Drejtoria Rajonale Tiranë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, që provon pagesën e tatimit në burim të qirasë për objektin dyqan, të ndodhur në Rr. “\*\*\*\*” Tiranë.

**59.1.6** Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit si dhe dokumentacionin e depozituar prej saj, vendosi të përfshijë në analizë financiare të ardhurat e plota nga dyqani, pasi subjekti provoi se ishin paguar detyrimet tatimore. Duke qenë se kontratat e qirasë janë lidhur me persona që ushtrojnë aktivitet tregtar, kanë detyrimin për pagimin e tatimit në zbatim të legjislationit në fuqi. Komisioni, në përfshirjen e të ardhurave në analizë financiare, u mbështet edhe në faktin që këto të ardhura janë deklaruar në DVP-të përkatëse, por edhe në deklaratën “Vetting”. Gjithashtu, nga vërtetimi i depozituar nga subjekti rezulton se për pagimin e detyrimeve tatimore nuk rezulton të jenë paguar gjoba, të cilat aplikohen në rastin e pagimeve me vonesë të detyrime tatimore, duke vërtetuar në këtë mënyrë pagesën në kohë të këtyre detyrimeve.

**59.2** Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se nga dhënia me qira e banesës ka përfituar të ardhura në shumën 2,760,000 lekë. Për të mbështetur deklaratimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion:

- kontratë nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, z. F. L;
- kontratë datë 1.8.2015, z. M. S.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion provues (përveç dy kontratave të mësipërme), për të provuar të ardhurat nga dhënia me qira e banesës, si dhe pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, për rrjedhojë, ato nuk janë përfshirë në analizën financiare.

**59.2.1** Në lidhje me këtë rezultat të hetimit, pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapëson: (i) nga Komisioni nuk është marrë në konsideratë shuma prej 96,000 lekësh qira e paguar në vitin 2014, deklaruar në DPV-në e vitit 2014, për të cilën është derdhur tatimi në burim sikundër provohet nga shkresa kthim-përgjigje datë 1.8.2019, e DRT-së Tiranë, si dhe kontrata e qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.10.2014 me: (ii) në lidhje me mospasjen e kontratave të qirasë, subjekti shpjegon se ambientet që japin me qira kryesisht janë për studentë. Kontratat kanë qenë njëvjeçare e për pasojë, në zbatim të nenit 803 të Kodit Civil, nuk ka pasur detyrim për lidhjen e tyre me shkresë; (iii) subjekti deklaroi se nga përmbajtja e shkresës kthim-përgjigje me nr. \*\*\* prot., datë 27.7.2017, të Drejtorisë Rajonale Tiranë, drejtuar ILDKPKI-së rezulton se në zbatim të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, germa “ë”, e nenit 33, detyrimi për të deklaruar dhe paguar tatimin në burim (tatim qiraje) është i tatimpaguesit (qiramarrës) me të cilin individit (qiradhënësi) ka lidhur kontratën e qirasë.

**59.2.2** Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej saj, konstaton se të ardhurat nga qiraja e banesës rezultojnë të deklaruara në deklaratat periodike, por edhe në deklaratën “Vetting”. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. \*\*\*, datë 6.12.2019, të Drejtorisë Rajonale Tiranë, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, që provon pagesën e tatimit në burim për dhënien me qira të një pjese të banesës. Në këtë vërtetim deklarohet se bashkëshorti

i subjektit të rivlerësimit si individ privat për tatimin mbi të ardhurat individuale në bazë të formularit të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave për vitet 2011– 2016 (tatim qiraje dhe të ardhura *bruto* të tjera të papërmendura më lart) ka deklaruar të ardhura, si më poshtë vijon:

Viti	Totali i të ardhurave <i>bruto</i>	Tatimi i paguar
2011	3,240,000	324,000
2012	444,444	44,000
2014	296,667	29,667
2015	166,000	24,900
2016	197,647	29,647

Subjekti, bazuar në nenin 803<sup>44</sup> paragrafi i fundit i Kodit Civil, nuk kishte detyrimin ligjor të lidhte kontratë me shkrim. Komisioni vlerëson se për sa kohë subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e banesës në DVP-të për vitet 2004 – 2016, ka paguar detyrimet përkatëse, si dhe provohet ekzistenca e dhënies me qira, për sa kohë bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016 deklaratimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë, të ardhurat nga qiraja duhet të përfshihen në analizë financiare. Komisioni, në lidhje me të ardhurat nga qiraja, i referohet edhe vendimet e tij të formës së prerë nr. 105, datë 12.2.2019; nr. 56, datë 1.8.2018; nr. 212, datë 22.12.2019; nr. 188, datë 24.7.2019.

## 60. Në lidhje me automjetet

### Rezultati i hetimit<sup>45</sup>

**60.1** Në datën 30.4.2001, me kontratën nr. \*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Daimler Chrysler” me targa \*\*\*, për shumën 500,000 lekë. Ky automjet është shitur nga bashkëshorti i subjektit me kontratën nr. \*\*\*, datë 16.6.2006, për shumën 600,000 lekë.

**60.2** Në datën 15.5.2002, me kontratën nr. \*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur automjetin tip “Mercedes Benz” për shumën 300,000 lekë. Ky automjet rezulton të jetë shitur para vitit 2003.

**60.3** Në datën 11.12.2006, me kontratën nr. \*\*\*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka shitur automjetin tip “Volkswagen” me targa \*\*\*, për shumën 300,000 lekë. Ky automjet është blerë nga bashkëshorti i subjektit në datën 17.12.2002, me kontratën nr. \*\*\*, për shumën 250,000 lekë.

**60.4** Bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 1.8.2008, rezulton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Mercedes Benz ML”, për shumën 12,000 euro – nga kjo shumë në datën 1.8.2008 është paguar vlera 7,000 euro, ndërsa pjesa tjetër do të likuidohet më 31.12.2008.

**60.4.1** Në datën 7.1.2009, me deklaratën noteriale nr. \*\*\* vërtetohet se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka paguar shumën 5,000 euro. Subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar kursime *cash* në DVP-në e vitit 2008, për rrjedhojë, nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të paguar shumën 5,000 euro për blerjen e këtij automjeti.

**60.4.2** Në datën 16.4.2015, me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, ky automjet është shitur për shumën 6,000 euro.

<sup>44</sup> Kontrata e qirasë për një kohë më të gjatë se një vit duhet bërë me shkrësë.

<sup>45</sup> Shkrësë nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2019, drejtuar noterit publik M. Xh.; shkrësë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbime të Transportit Rrugor.

**60.4.3** Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për mungesë të ardhurash për pagesën e shumës 5,000 euro në fillim të vitit 2009.

**60.4.4** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, sqaroi se në të gjitha deklaratat e pasurisë nga vitet 2003 – 2015 nuk ka deklaruar gjendjen *cash*. Për herë të parë gjendjen *cash* në banesë e ka pasqyruar në DPV-në e vitit 2016. Pavarësisht mosdeklarimit të gjendjes *cash* në deklaratat periodike vjetore të pasurisë, viti pasardhës, pra, pas datës 31 dhjetor, gjendja e saj ekonomike nuk ishte zero lekë, pra, në datën 1 janar të çdo viti familjar kishte likuiditete. Subjekti pranon faktin se pa asnjë qëllim ka qenë gabim njerëzor prej saj mosdeklarimi i gjendjes *cash* në banesë. Bilanci i viteve paraardhëse minimalisht 2007 dhe 2008 janë pozitivë në një vlerë të konsiderueshme, për këtë arsye subjekti kërkon që vlerat që dalin si mundësi kursimi, të merren në konsideratë si gjendje të ardhurash të ligjshme në banesë.

**60.4.5** Subjekti ka parashtruar se po të shikohet me kujdes deklarata e pagimit të këstit të dytë, në deklaratën noteriale të datës 1.8.2008, parashikohet se vlera prej 5,000 euro do të likuidohet deri në fund të dhjetorit të këtij viti, pra, brenda datës 31.12. 2008, por për shkaqe të pavarura, pagesa nuk u bë më 31 dhjetor kur ishte parashikuar, por u bë më 7.1.2009. Në këto kushte, subjekti pretendon për një gabim njerëzor nga ana e saj për mosdeklarimin e gjendjes *cash* në DPV-në e vitit 2008, minimalisht shuma e cila ishte mbledhur për pagimin e vlerës së mbetur nga blerja e automjetit. Por ky deklaram ka qenë i saktë qoftë si detyrim i mbartur nga viti 2008, ashtu edhe si likuidim në vitin 2009.

**60.4.6** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se janë në nivel deklarativ dhe nuk mbështeten në asnjë provë për të vërtetuar gjendjen *cash* në banesë. Është e vërtetë që subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë kursime *cash*, si dhe në disa vite del me një gjendje të konsiderueshme mundësish kursimi në fund të vitit, por për sa kohë nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar qoftë në deklaratën “Vetting” apo në DVP-të si burim kursimet *cash*, Komisioni nuk i merr në konsideratë këto gjendje të dala nga analiza financiare si kursime *cash*. Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka të ardhura të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në fillim të vitit 2008.

**60.4.7** Në përfundim të hetimit në lidhje me këtë automjet, duke marrë në konsideratë faktin se viti 2009 rezulton me një bilanc pozitiv në shumën 1,495,769 lekë, për vitet 2006 – 2009 me një bilanc në total 623,697 lekë, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie në raport me provat e tjera të administruara nëpërmjet hetimit, Komisioni vlerëson se mungesa e të ardhurave për pagesën e këstit të dytë të automjetit nuk mund të shërbejë si shkak për masë disiplinore, duke qenë se nuk përmbushen kriteret e parashikuara në pikat 1 dhe 3 të nenit 61.

**60.4.8** Në datën 31.8.2006, me kontratën nr. \*\*\*, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin tip “Fiat Punto” për shumën 150,000 lekë dhe ka paguar dhe detyrimet doganore në shumën prej 113,975 lekësh, bazuar në dokumentin “vërtetim zhdoganimi” datë 22.9.2006, si dhe në deklaratën doganore import 4, të datës 22.9.2006. Në datën 11.4.2013 subjekti i rivlerësimit, me kontratën nr. \*\*\*, ka shituar automjetin tip “Fiat Punto” për shumën 400,000 lekë.

## **70. Në lidhje me të dhënat e AMF-së**

**70.1** Nga të dhënat e AMF-së rezulton se z. D. G., ka policë sigurimi në emër të tij për automjetin me targa \*\*\*, ku te të dhënat e policëmbajtësit rezulton përdorues. Policat janë si më poshtë:

- 20.4.2017 – 19.4.2018;
- 8.8.2017 – 22.8.2017;
- 13.8.2016 – 27.8.2016.

**70.2** Nga hetimi administrativ ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimet në datën 12.8.2016, me kontratë huapërdorje nr. \*\*\* ka marrë nga shtetasi Sh. N., automjetin tip “Ford”, me targa \*\*\* për ta përdorur pa afat.

**70.3** Ky automjet nuk rezulton i deklaruar nga subjekti i rivlerësimet në deklaratën “Vetting”.

**70.4** Pas kalimit të barrës së provës subjekti shpjegoi se në pyetësorin e parë, pyetjes së pestë e cila ishte: *A keni përdorur në shtatë vitet e fundit pasuri të regjistruara në emrin e dikujt tjetër si automjete, shtëpi, anije, apartamente, shtëpi pushimi etj.*, i është përgjigjur, po, kemi përdorur automjete. Ky automjet është përdorur prej saj vetëm në pak raste dhe këto kryesisht vetëm për udhëtime jashtë shtetit. Me përmbajtjen e kontratës së huapërdorjes së mjetit, e cila rezulton pa afat e ka lexuar vetëm pasi u njoh me rezultatet nga Komisioni. Automjetin nuk e kanë pasur në përdorim të përditshëm, atë e ka mbajtur, disponuar dhe gëzuar pronari i sendit z. Sh. N. Kontrata e huapërdorimit pavarësisht se është shkruar pa afat, realisht ata nuk e kanë përdorur në përditshmëri këtë automjet. Mosdeklarimi i këtij automjeti në përdorim në deklaratën “Vetting” prej saj, ka qenë vetëm për faktin se automjeti është përdorur shumë pak herë vetëm për disa raste udhëtime jashtë shtetit, sikundër provohet edhe nga sistemi *TIMS*.

**70.5** Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit, konstaton se nuk ka qenë e saktë në plotësimin e deklaratës “Vetting”, pasi nuk ka deklaruar kontratën e huapërdorjes në lidhje me këtë automjet. Ndërkohë, subjekti, në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar se ka përdorur automjete në emër të personave të tjerë. Nga të dhënat e AMF-së rezulton se në vitin 2016 subjekti ka prerë policë sigurim për këtë automjet vetëm për 14 ditë, duke u provuar se nuk e ka pasur në përdorim këtë automjet në vitin 2016. Nga të dhënat e sistemit *TIMS* rezulton se ky automjet është përdorur për të dalë jashtë shtetit në datën 13.8.2016 dhe është futur më 21.8.2016, pra, brenda afatit të policës. Subjekti ka depozituar në seancën dëgjimore të datës 9.1.2020 zgjidhjen e kontratës nr. \*\*\* datë 26.12.2019, nëpërmjet së cilës është zgjidhur kontrata e huapërdorjes.

**70.6** Duke qenë se ky automjet nuk është përdorur gjatë gjithë kohës, duket/rezulton se subjekti nuk ka pasur për qëllim të fshehtë apo të deklarojë në mënyrë të pasaktë këtë automjet. Trupi gjykues vlerëson se nuk lindin dyshime për fshehje pasurie, për aq kohë sa dhe polica e sigurimit është prerë vetëm për dy javë dhe vërtetohet nëpërmjet sistemit *TIMS* se automjeti është përdorur këto dy javë për udhëtim jashtë vendit. Pavarësisht kësaj, mbetet fakt që subjekti nuk ka qenë i saktë në deklaratën “Vetting”, pasi nuk ka deklaruar kontratën e huapërdorjes të këtij automjeti.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**71.** Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacionin justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

**71.1** Nga ana formale, Komisioni konstaton se subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë.

**71.2** Pasi u morën në konsideratë rezultatet e hetimit administrativ, të kryer kryesisht nga Komisioni, parashtrimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, si dhe e dëgjoi në seancat dëgjimore, trupi gjykues, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konkludon se:

- i. ka pamjaftueshmëri mjetesh financiare në shumën prej 596,181 lekësh, për vitin 2005;
- ii. ka pamjaftueshmëri mjetesh financiare për blerjen e automjetit në shumën 5,000 euro, në vitin 2008;
- iii. nuk ka deklaruar posedimin dyjavor të automjetit në gusht të vitit 2016.

**71.3** Pavarësisht mangësive të evidentuara në pikën më sipër, subjekti ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimet

nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë, që në rastin e subjektit Alkelina Gazidedja, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**71.4** Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram dhe balanca negative e fondeve në vitet 2005 dhe 2008, nuk është e mjaftueshme që të passjellë aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analize kritike, por duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Për më tepër, Komisioni gjatë hetimit administrativ konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

**71.5** Komisioni çmon se subjekti, pavarësisht se ka pasur pasaktësi në deklarime apo mungesë të të ardhurave në momente të caktuara, përgjatë deklarameve të pasurisë ndër vite, nuk ka pasur për qëllim të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë. Deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura ndër vite, nga subjekti në ILDKPKI, mund të përdoren si provë nga Komisioni, bazuar në pikën 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, por këto prova duhet të analizohen në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të pasurisë. Duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, duke vënë në balancë vlerën e këtyre pasaktësive, në raport me provat e tjera të administruara nëpërmjet hetimit, Komisioni konstaton se subjekti ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.

**71.6** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të në deklaratën “Vetting”, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**71.7** Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër, nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

## **B. VLERËSIMI I FIGURËS**

**72. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

**73.** Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar *përshtatshmërinë* për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja.

**74.** Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha



faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti Alkelina Gazidedja, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës sipas parashikimit germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor**

**75.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**75.1** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

**75.2** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**75.3** Saktësia e formularit të vetëdeklarimit: formulari paraqitet i plotë dhe i nënshkruar në çdo faqe, sipas parashikimit të udhëzimit të shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**75.4** Të dhëna nga burime arkivore të KLD-së: sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin janë paraqitur 6 ankesa (5 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së, 3 ankesa (2 në vitin 2014 dhe 1 në vitin 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor.

**75.5** Tri ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë, si më poshtë:

- dy ankesa të vitit 2014 të verifikuara bazuar mbi informacionin periodik të kryetarit lidhur me vendimet e cenuara dhe dorëzimin me vonesë të vendimeve të arsyetuara i janë regjistruar gjyqtarës për efekt vlerësimi profesional dhe etik;
- një ankesë e vitit 2014 e verifikuar për mosrespektim formal ligji është në vijim verifikimi deri në përfundim të gjykimit në shkallët më të larta.

**75.6** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

**75.7** Komisioni<sup>46</sup> i ka kërkuar informacion KLGj-së dhe Ministrisë së Drejtësisë në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

**75.7.1** Bazuar në shkresën e Ministrisë së Drejtësisë rezulton:

---

<sup>46</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe KLD-së.

**a.** Ministria e Drejtësisë ka inspektuar Gjykatën Administrative të Apelit për periudhën 15.12.2014 – 23.1.2015 me objekt inspektimi “verifikimi i zbatimit të dispozitave procedurale dhe administrative në gjykimin e çështjeve të regjistruara në këto gjykata.” Në përfundim të inspektimit është përgatitur një raport për të gjithë anëtarët e kësaj gjykate, ku për subjektin e rivlerësimit rezultojnë këto të dhëna:

- i. subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar jashtë afatit ligjor 400 vendime nga 513 në total, me një vonesë kohore 11-116 ditë, duke mosrespektuar në këtë mënyrë dispozitat e nenit 55 të ligjit nr. 49/2012;
- ii. subjektit të rivlerësimit i janë caktuar me short 1453 çështje administrative, nga të cilat ka përfunduar gjykimi dhe janë shpallur 530 vendime, duke qenë në proces 923 çështje, për të cilat rezulton se nuk është respektuar afati 30-ditor i parashikuar nga nenin 48 i ligjit nr. 84/2012. Në lidhje me 530 çështjet e vendimuara rezulton se 343 prej tyre janë shqyrtuar tej afatit 30-ditor, me një vonesë kohore nga 1 muaj-mbi 5 muaj;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka caktuar data për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi 1-2 muaj nga data e regjistrimit të çështjes duke tejkaluar afatin 30-ditor;
- iv. periodiciteti i seancave gjyqësore në rastet kur gjykata ka vendosur shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore është shumë i madh, duke u bërë shkak për kohëzgjatjen e madhe të procesit. Shpesh herë afati nga njëra seancë në tjetrën është mbi një muaj.

Në lidhje me këto konstatime, nga kryetari i Gjykatës së Apelit Administrativ, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2014<sup>47</sup> është parashtruar se:

- i. Gjykata Administrative e Apelit nuk ndihmohet nga ndihmësit ligjor sipas përcaktimeve të ligjit nr. 49/2012;
- ii. gjyqtarët kanë realizuar ngarkesën në punë duke qenë në vështirësi në lidhje me shërbimet mbështetëse, pasi nga numri i vogël i administratës nuk ka qenë e mundur që çdo gjyqtar të asistohet nga një sekretar gjyqësor. Aktualisht, një sekretar gjyqësor mbulon dy gjyqtarë;
- iii. nisur nga volumi i çështjeve të trajtuara, veçanërisht, në mars-prill të vitit 2014 u krijua pamundësi objektive për dorëzimin e vendimeve, të arsyetuara në afatin e përcaktuar.

Nga Inspektorati i KLD-së<sup>48</sup>, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.1.2016 është konstatuar:

*“Dorëzimi me vonesë i vendimeve të arsyetuara ka ardhur si pasojë e shkaqeve objektive dhe jo për shkaqe subjektive apo neglizhencë të gjyqtarëve, shkeljet formale të ligjit do t’i evidentohen për efekt vlerësimit etik e profesional gjyqtarëve...”*

Komisioni, në lidhje me konstatimet e aktit të Inspektimit të Ministrisë së Drejtësisë, vlerëson që për të gjithë anëtarët e Gjykatës Administrative të Apelit janë konstatuar të njëjtat problematika, të cilat kanë ardhur si pasojë e ngarkesës së madhe në punë të kësaj gjykate, si dhe të mungesës së këshilltarëve dhe sekretareve gjyqësore. Për sa kohë këto konstatime janë evidentuar nga organet e tjera për efekt të vlerësimit etik dhe profesional, Komisioni e ka konsideruar të panevojshme kërkimin e shpjegimeve të subjektit së bashku me rezultatet e hetimit.

**b.** Për subjektin janë paraqitur katër ankesa, të cilat pasi janë analizuar nga Komisioni është konstatuar se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

**75.7.2** Bazuar në shkresën e KLGJ-së rezulton se:

- subjekti i rivlerësimit është vlerësuar shumë mirë për periudhën 2005 - 2006 dhe 2007 – 2009;

<sup>47</sup> Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. \*\*\* prot., datë 7.1.2019, nga KLGj-ja.

<sup>48</sup> Shihni dokumentacionin e depozituar nga subjekti pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ.

- për subjektin janë paraqitur 9 ankesa, të cilat pasi janë analizuar nga Komisioni është konstatuar se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me ankesën e shtetasve B. S., dhe G. K., të cilët kanë pretenduar se fillimisht është pranuar kërkesa për masë sigurimi dhe pas përfshirje në gjykim të ndërhyrësit dytësorë, trupi gjykues ka vendosur fillimisht revokimin e masës së sigurimit, pasi në marrjen e vendimit kishte marrë pjesë një nga anëtarët e trupit që kishte dhënë dorëheqje dhe më pas ka rrëzuar kërkesë e palës paditëse për masën e sigurimit.

Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Vendimi i masës së sigurimit i caktuar në seancën e datës 24.9.2008, është marrë me argumentimin se mbi pasurinë e paditësve me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\* Tiranë, kërkohej të inskriptohet vendimi objekt gjykimi nr. \*\*\*, datë 9.5.2008, i Agjencisë se Kthimit të Pronave. Duke marrë në konsideratë shmangien e transferimeve të mëtejshme të kësaj prone, derisa të kthehej në titull ekzekutiv vendimi nr. \*\*\*, datë 9.5.2008 i AKP-së u vendos pezullimi i ekzekutimit të këtij vendimi. Gjatë procesit, ndërhyrësi dytësor ka paraqitur kërkesë për revokimin e masës së sigurimit, duke parashtruar edhe shkaqet përkatëse. Gjykata ka vendosur në seancën e datës 2.12.2008 heqjen e masës së sigurimit të marrë me vendimin e datës 24.9.2008, me nr. \*\*\* akti. Shkaku për të cilin kjo gjykatë ka marrë këtë vendim nuk lidhet aspak me ndryshimin e trupit gjykues, nga arsytimi i vendimit rezulton qartësisht shkaku i revokimit të vendimit të ndërmjetëm, bazuar në nenet 207, 329 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata në asnjë moment të arsytimit të saj nuk e ka mbështetur vendimin e heqjes së masës në faktin se gjyqtari A. Zh., u përjashtua nga ky gjykim. Shkaku që është hequr masa e sigurimit ka qenë çmuarja e rrethanave, të cilat kishin krijuar bindjen se nga ekzekutimi i këtij vendimi do t'i vinte dëm i pariparueshëm paditësit”.*

Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se janë bindëse. Subjekti ka shpjeguar qartë duke provuar me dokumentacion provues se nuk ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Procedurës Civile, si dhe nuk e ka mbështetur kërkesën<sup>49</sup> për revokimin e masës së sigurimit në arsyet e pretenduara nga ankuesit. Për më tepër, në përfundim të gjykimit është vendosur pranimi i padisë, i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit.

c. Nga KLD-ja i është paraqitur informacion nënkryetarit të KLD-së në lidhje me vendimet e Gjykatës së Rrethit Tiranë, të cenuara nga Gjykata e Lartë. Në këtë informacion është konstatuar se subjektit i janë cenuar dy vendime, si më poshtë:

1. Vendimi nr. \*\*\*, datë 3.2.2010 është ndryshuar me vendim nr. \*\*\*, datë 3.4.2014, e cila ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë për sa i përket kërimit për rikthimin në punë.”*

Gjykata e Lartë arsyeton: *“Në vendimin unifikues nr. 31/2003 thuhet: E drejta e rikthimit në punë nuk gëzon mbrojtje gjyqësore...”*

Në lidhje me këtë konstatim, pavarësisht se Komisioni nuk i ka kërkuar shpjegime subjektit, duke qenë se i përket themelit të çështjes, ajo ka sqaruar se: *“Vendimi nr. 31/2003, të cilit i referohet kolegji administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka të bëjë me punëmarrësit/punonjës të doganës, marrëdhëniet e të cilëve rregullohen nga dispozitat e Kodit të Punës. Përkundrazi, ky vendim unifikues është marrë ndaj punonjësit të policisë. Në këto kushte, ky vendim nuk mund të gjente zbatim në rastin e paditësit B. D., çështjes që unë kam gjykuar. Sqaroj se në lidhje me zbatimin e paragrafit të tretë të neneve 146 dhe 155 të Kodit të Punës, praktika gjyqësore ishte e ndarë në*

<sup>49</sup>Shihni vendimin nr. \*\*\* akti, datë 5.12.2008, depozituar nga subjekti së bashku me parashtrimet për rezultatet e hetimit administrativ.

*dy qëndrime, për këtë shkak Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë morën vendimin unifikues nr.19/2011.”*

2. Vendimi nr. \*\*\*, datë 6.5.2008, është ndryshuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.2.2014, e cila ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e padisë. Vendimi është ndryshuar duke interpretuar ndryshe nenin 153 të Kodit të Punës dhe të provave.

Në lidhje me këtë konstatim, pavarësisht se Komisioni nuk i ka kërkuar shpjegime subjektit duke qenë se i përket themelit të çështjes, ajo ka sqaruar se: *“Vendimmarrja ka qenë e bazuar mbi një analizë të hollësishme të provave objekt gjykimi dhe mosmarrëveshjes së shtruar për zgjidhje përpara gjykatës. Nga provat e nënshtruara debatit gjyqësor, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, mbi bindjen e brendshme ka konkluduar se pala e paditur nuk ka provuar me prova shpresore se paditësja kishte kryer shkeljen e pretenduar prej tyre të vënë si motivacion në urdhrin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës. Mbi këto fakte dhe rrethana ka dhënë vendimin objekt hetimi administrativ.”*

Në lidhje me dy vendimet e mësipërme, Komisioni nuk i ka kërkuar shpjegime subjektit, pasi kanë të bëjnë me themelin e çështjes dhe nuk rezultojnë të jetë kryer asnjë shkelje procedurale prej tij, por, pavarësisht këtij fakti, nga subjekti janë dhënë shpjegime bindëse në lidhje me vendimmarrjen e saj.

**76.** Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit: (1) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti; (2) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (3) të dhënat nga burimet arkivore në KLD.

### ***Aftësitë profesionale***

#### ***76.1 Njohuritë ligjore***

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme. Kur është rasti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit, ajo përdor referenca në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

#### ***76.2 Arsytimi ligjor***

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare, përgjithësisht, është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve të mosmarrëveshjes dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

### ***Aftësitë organizative***

**76.3** Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, subjekti ka përfunduar gjithsej 1361 çështje gjyqësore, nga të cilat 937 administrative dhe 424 marrëdhënie pune. Standardet matëse për sasinë e sistemit të vlerësimit të Gjyqtarëve nuk zbatohen drejtpërdrejt për gjyqtarët e gjykatave administrative, pasi janë miratuar nga ish-KLD-ja përpara fillimit të funksionimit të këtyre gjykatave. Konkretisht, ky sistem vlerësimi nuk njihet seksion administrativ në Gjykatat e Apelit.

Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve në referim të datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit Administrativ ka qenë në intervale kohore nga 2 muaj e një ditë deri në një vit 10 muaj e 17 ditë.

Kohëzgjatja efektive e gjykimeve (në referim të datës së listë-shpalljes nga kryetari i gjykatës me të cilën është caktuar seanca e parë gjyqësore) nga gjyqtarja ka qenë në intervale kohore nga 23 ditë deri në 1 muaj e 4 ditë. Katër nga pesë çështjet e vëzhguara janë gjykuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga pika 2, e nenit 48,<sup>50</sup> të ligjit nr. 49/2012.

Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga pesë dosjet e vëzhguara, vetëm dy vendime janë arsyetuar brenda afatit 7-ditor të parashikuar nga pika 3, e nenit 55, të ligjit nr. 49/2012.

KL Gj-ja konstaton se pavarësisht se për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afatit ligjor (1 muaj) nuk varej gjithçka nga subjekti, pasi planifikimi i seancës së parë gjyqësore bëhej nga kryetari i gjykatës, me urdhër të të cilit sekretaria gjyqësore bën shpalljen e listës së gjykimeve, subjekti nuk ka bërë përpjekjet e duhura për arsyetimin e vendimeve në respektim të afatit ligjor (7 ditë), të parashikuar nga neni 55/3 i ligjit nr. 49/2012.

### **76.3.1** Në lidhje me këtë konstatim të KLGj-së, subjekti ka dhënë këto shpjegime:

Ngarkesa në punë si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit ka qenë tej normës normale të ngarkesës së një gjyqtari të Gjykatës së Apelit. Mosrespektimi i afatit të gjykimit brenda 30 ditëve është prezent edhe sot. Ky mosrespektim vjen nga një faktor objektiv i pavarur prej saj, që është ai i ngarkesës së madhe të dosjeve që ka pasur për gjykim, objektivisht është e pamundur me numrin e çështjeve të shortuara për gjykim që znj. Alkelina Gazidedja të zhvillojë seancat brenda një afati 30-ditor, për të njëjtin shkak ka pasur vonesa në arsyetimin e vendimeve. Në total, si trup gjykues, së bashku me dy anëtarët e tjerë, në vitin 2013, ka gjykuar me përafërsi 1650 çështje. Për vitin 2015 ka gjykuar si relatore dhe anëtare 1800 çështje. Ngarkesa e lartë në punë është evidentuar edhe nga raporti i inspektimit të kryer nga Ministria e Drejtësisë, në korrik 2015. Sipas urdhrit nr. \*\*\*, datë 2.12.2013, është urdhëruar që sekretarja gjyqësore të punojë, si e tillë, me trupin gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Nga momenti i krijimit të gjykatës deri në qershor 2015 kjo gjykatë nuk ka pasur ndihmës ligjorë, sikundër e parashikonte ligji nr. 29/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**76.4** Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në të pesë dosjet e vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë në dhomë këshillimi, të cilat kanë qenë produktive, në përfundim të të cilave është shpallur vendimi. Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short rezultoi se secili gjykim ka përfunduar me një seancë të vetme në dhomë këshillimi dhe gjykimi ka filluar në orën e caktuar.

**76.5** Aftësia për të administruar dosjet. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se, përgjithësisht, aktet themelore janë të rregullta.

Në të pesë dosjet e vëzhguara gjendet relatimi i subjektit të rivlerësimit, i nënshkruar në fund prej tij. Në të pesë dosjet gjendet vendim “për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi”. Në fashikullin e gjykimit janë përfshirë aktet e njoftimit të palëve për 2 çështje dhe kopje të listave të gjykimit, të firmosura nga kryetari i gjykatës për 3 çështje. Aktet e përfshira në dosje janë të sakta dhe në përputhje me kriteret e caktuara nga ligji.

### ***Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale***

**76.6** *Etika në punë.* Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore për subjektin përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

---

<sup>50</sup> “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata, ku është paraqitur ankimi.”

**76.7 Integriteti.** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

**76.8 Paanësia.** Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit. Asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar rregullat procedurale.

#### ***Aftësitë personale dhe angazhimi profesional***

**76.9 Aftësitë e komunikimit.** Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve. Në të tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

**76.10 Aftësia për të bashkëpunuar.** Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

**76.11 Gatishmëria për t'u angazhuar.** Subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së dytë (administrative), i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, subjekti ka marrë pjesë në 13 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës dhe 2 seminare jashtë Shkollës së Magjistraturës (shih trajnimet në tre vitet e fundit). Këto të dhëna tregojnë se subjekti ka marrë pjesë në 18 ditë të formimit vazhdues për periudhën e rivlerësimit dhe se lënda e trajnimeve ku ka marrë pjesë ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të Apelit Administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka kryer studimet Master në të Drejtën Civile, si dhe ka fituar gradën shkencore “Doktor” në vitin 2017.

#### **Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

**77.** Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLGj-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kritereve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

**78.** Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet penale të përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

**79.** Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLGJ-ja, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

#### **❖ Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit**

**80.** Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 27 denoncime të paraqitura në Komision. Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, për shkak të këtyre denoncimeve, rezulton se në të gjitha denoncimet nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit. Ndërkohë, në lidhje me 6 denoncime, Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit.

**80.1** Me denoncim nr. \*\*\*, datë 15.8.2018, znj. B. Z., ankohet për disa subjekte rivlerësimi, ndër to, edhe znj. Alkelina Gazidedja, duke pretenduar se trupi gjykues nuk ka marrë një vendim të drejtë.

**80.1.1** Komisioni, pasi analizoi vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ, i ka kërkuar shpjegime subjektit se cila ka qenë arsyeja e përsëritjes pjesërisht të hetimit gjyqësor, duke i parashtruar pyetje ekspertëve, për sa kohë nga trupi gjykues është konstatuar se nuk është formuar drejt ndërgjyqësia.

**80.1.2** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti shpjegoi se hetimi i plotë dhe i gjithanshëm është detyrë e gjykatës. Duke u nisur nga ky parim është zhvilluar edhe gjykimi në rastin konkret. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor ishte e domosdoshme zhvillimi i çështjes në seancë gjyqësore, si dhe pyetja e ekspertëve në këtë proces, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor u konkludua se titulli i pronësisë që kundërshtonte pala paditëse ishte pikërisht akti që kishte nxjerrë pala e tretë në proces, sikundër është arsyetuar edhe në vendimin gjyqësor, e cila pozitën e saj procedurale e kishte si personi i tretë, kur në fakt ishte organi vendimmarrës.

**80.1.3** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë denoncim.

**80.2** Me denoncimet nr. \*\*\*, datë 9.11.2018 dhe nr. \*\*\*, datë 15.1.2019, znj. D. Ç., ankohet se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pa të drejtë për dërgimin e çështjes për rigjykim për shkak se nuk është formuar drejt bashkëndërgjyqësia. Në vijim të këtyre denoncimeve ka paraqitur denoncime edhe znj. D. Z<sup>51</sup>, duke pretenduar se çështja është zvarritur.

Komisioni, në lidhje me këto denoncime, konstatoi se nga skedari i nxjerrë nga faqja zyrtare e Gjykatës Administrative të Apelit rezulton se çështja është regjistruar në datën 7.9.2016 dhe vendimi është marrë në datën 4.6.2018, pra, gati dy vjet më vonë duke i kërkuar subjektit të japë shpjegime.

**80.2.1** Subjekti sqaroi se vonesa në gjykimin jo vetëm të kësaj çështjeje, por në përgjithësi për të gjitha çështjet, që i janë shortuar, kanë ardhur si rezultat i ngarkesës së madhe në punë, numrit tepër të madh të çështjeve të shortura. Është e pamundur me ngarkesën e dosjeve që presin radhën për gjykim, dhe as e mundur efektivisht/objektivisht me gjithë përpjekjet e saj, që çështjet të shqyrtohen brenda afati 30-ditor, që parashikon neni 48 i ligjit nr. 49/2012. Gjithashtu, shtetasja D. Z. (Ç) ka bërë dy ankesa në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, i cili, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 28.6.2017, ka vendosur arkivimin e ankesës së shtetasës D. Z., ndaj veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarës Alkelina Gazidedja, të Gjykatës Administrative të Apelit. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.5.2019, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur mospranimin e ankimit nr. \*\*\*, datë 18.6.2018, të shtetasës D. Z. (Ç).

**80.2.2** Komisioni vlerëson se është fakt që nga subjekti kjo çështje është gjykuar me vonesë, por bazuar në shpjegimet e saj, si dhe në situatën në të cilën gjendet Gjykata Administrative e Apelit si një gjykatë e vetme apeli në të gjithë Republikën e Shqipërisë, me një ngarkesë të madhe të dosjeve gjyqësore, duket e pamundur të respektohen afatet e parashikuara nga legjislacioni procedural administrativ.

---

<sup>51</sup> Denoncimi nr. \*\*\*, datë 16.10.2018 dhe denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2019.

**80.3** Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 18.1.2018, z. K. D., pretendon se gjykata ka shfuqizuar vendimin e shkallës së parë, duke i vjedhur pronën. Eksperti ka qenë pa licencë, si dhe është gjë e gjykuar, pasi padia është gjykuar në themel në të tria shkallët e gjykatës më parë. Gjithashtu, denoncuesi pretendon se çështja nuk duhej të gjykohej nga kjo gjykatë, por nga Gjykata Civile, duke i akuzuar për korrupsion, shpërdorim detyre dhe joprofesionalizëm.

**80.3.1** Në analizë të dokumentacionit të administruar, në përfundim të hetimit subjektivit i janë kërkuar shpjegime në lidhje me konstatimet e mëposhtme:

- a. Ndërgjyqësia nuk është rregulluar konform Kodit të Procedurës Civile, pasi znj. M. D., nëpërmjet padisë i cenoheshin interesat e drejtpërdrejta, për sa kohë nga pala paditëse është kërkuar çregjistrimi i pasurisë së paluajtshme në pronësi të saj.
- b. Nga gjykata, kryesisht, është njohur pronar z. B. K., mbi pasurinë objekt gjykimi, pavarësisht se kjo nuk ishte në objektin e padisë.
- c. Gjykata është kontradiktore në argumentim, pasi fillimisht deklaron se objekti i gjykimit është veprimtaria e ZVRPP-së dhe gjykimi nuk është konflikt pronësie dhe më pas shprehet se paditësi provoi se është pronar.
- d. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se në çështje të ngjashme trupi gjykues, ku në përbërje ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, ka argumentuar ndryshe:
  - i. në vendimin nr. \*\*\*, datë 21.6.2018;
  - ii. në vendimin nr. \*\*\*, datë 18.2.2019.
- e. Nga gjykata është caktuar si ekspert z. F. B., i cili, bazuar në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2017, rezulton se nuk zotëron licencë të vlefshme për studim e projektim dhe mbikëqyrje e kolaudim në fushën e topografisë.

**80.3.2** Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, shpjegoi: Në zgjidhjen e kësaj çështjeje kolegji i është referuar praktikës së Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si p.sh., vendimi nr. \*\*\*, datë 12.6.2014. Në vendimin e dhënë si trup gjykues janë marrë në analizë të gjitha pretendimet e palëve, për faktin se ato çfarë ngrihen në këtë rast kanë qenë edhe shkaqet për të cilat Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë. Në vendim janë marrë në analizë të gjithë këto elemente. Ajo që është konkluduar në këtë vendim është përparësia në regjistrim dhe verifikimin e veprimtarisë së ZVRPP-së Tiranë në regjistrimet e pronave, sikundër në rastin konkret. Paditësi e ka pasur të regjistruar pronën që në vitin 1992 me nr. \*\*\*, datë 5.9.1992, ndërsa personi i tretë e ka regjistruar pronën me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.1995 dhe e ka regjistruar në ZVRPP me nr. hipotekor \*\*\*, datë 19.12.1995.

Për sa i përket konstatimit se çështja përbën gjë të gjykuar, i është dhënë përgjigje në vendim, faqja 18-19, pasi nuk plotësohen kushtet e nenit 451/a të Kodit të Procedurës Civile.

Nga aktet rezulton se pikërisht për shkak të mbivendosjes së pronës së palës së tretë me paditësin për sip. 120 m<sup>2</sup>, të cilën paditësi e kishte fituar me kontratë shitjeje që në vitin 1992, ZVRPP-ja Tiranë kur ka regjistruar pronën e personit të tretë e ka ndarë në dy pasuri, njëra me sip. 756.6 m<sup>2</sup> dhe tjetra me sip. 120 m<sup>2</sup> (sqaroj se në bazë të ligjit nr. 33/2012 ndarja e pasurisë bëhet vetëm me kërkesë të pronarit), duke nxjerrë urdhër kufizimin nr. \*\*\*, datë 28.9.2015, me argumentin se ka mbivendosje me pronën e z. B. K. Pra, në këtë gjykim ajo që është provuar është se paditësi e ka të regjistruar pronën me herët se denoncuesja mbi bazën e një akti kontratë shitjeje, fakt i cili është pranuar si nga personi i tretë, po ashtu edhe nga i padituri ZVRPP, sepse është kryer ndarja e pasurisë në dy pasuri. Në vendim është arsyetuar se personi i tretë ka të drejtë të ngrëjë padi për të kundërshtuar titullin e pronësisë së paditësit, sepse pikërisht për shkak të regjistrimit të pronës së tij të fituar me kontratë shitjeje që në vitin 1992, përpara se kjo pronë të trajtohej me vendim të kthimit dhe kompensimit të pronave në favor të personit të tretë, kur në atë kohë trulli ishte shitur edhe ndërtesa e paditësit ishte ndërtuar.



Subjekti ka depozituar në Komision licencën nr. \*\*\* të ekspertit F. B., nga ku rezulton se ka profesion teknik i mesëm topograf, si dhe është regjistruar në regjistrin themeltar të gjeodetëve për kategoritë e punimeve: rlevime topografike dhe licencë nr. \*\*\*, nga ku rezulton se ka titullin teknik topograf dhe është licencuar për rlevime inxhinierike kadastrale që nga data 27.4.2017.

**80.3.3** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar prej saj, konstaton se ato janë bindëse, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë denoncim. Trupi gjykues vlerëson se një pjesë e konstatimeve të denoncimit kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit, për rrjedhojë, Komisioni nuk mund të zëvendësojë interpretimin dhe logjikën e subjektit në vlerësimin e provave dhe ligjit bazuar në standardin ligjor për vlerësimin e gjyqtarit, i vendosur në pikën 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016, e cila parashikon: *“Vlerësuesi çmon aftësitë gjyqësore pa gjykuar korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit që vlerësohet”*.

**80.4** Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 15.1.2018, Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve pretendon se nga Gjykata Administrative e Apelit janë marrë disa vendime të pabazuara, duke pretenduar se subjekti i rivlerësimit është shprehur ndryshe në dy vendime për të njëjtin objekt kërkimi, ku si palë e paditur ka qenë kantieri, ndërsa si palë paditëse ish-punonjësit.

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar rezulton se:

**80.4.1** Në dispozitivin e vendimit nr. \*\*\*, datë 6.12.2017, nga Gjykata Administrative e Apelit është shtuar detyrimi i palës së paditur që t'i paguajë 3 muaj pagë për zgjidhje të menjëhershme palës paditëse, përtej kërkimit të saj në padi. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me këtë konstatim.

**80.4.1.1** Subjekti, në lidhje me këtë, ka sqaruar se në vendimmarrje janë nisur nga objekti i mosmarrëveshjes, e cila ka të bëjë me marrëdhëniet e punës të rregulluara, në këtë rast, nga dispozitat e Kodit të Punës, ku si dëmshpërblime në rast të konstatimit të zgjidhjes së marrëdhënies së punës nga punëdhënësi pa shkaqe të arsyeshme ose të justifikuara janë dëmshpërblim për mosrespektim të afatit të njoftimit, dëmshpërblim për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së marrëdhënies së punës, dëmshpërblim që rrjedh nga neni 146 ose 155, si dhe shpërblimi për vjetërsinë në punë. Nisur nga këto dispozita është marrë edhe vendimi objekt gjykimi, i cili mbi rekursin e palës së paditur ndodhet në Gjykatën e Lartë. Gjykata Administrative e Apelit, në gjykim, ka mbajtur në konsideratë edhe qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të cilat në vendimin unifikues nr. 3/2012 konkludojnë se: *“Gjykata kur zgjidh mosmarrëveshjen merr në shqyrtim pretendimet e paditësit, të cilat parashtrihen në kërkesëpadi, si dhe gjatë ushtrimit të së drejtave që rrjedhin nga procesi, duke mbajtur parasysh se konform neneve 5, 31, 154 e 185 të Kodit të Procedurës Civile objekti i padisë dhe shkakut i saj nuk përmbledhen domosdoshmërisht vetëm në pjesën hyrëse të kërkesëpadisë”*.

**80.4.1.2** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se janë bindëse, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë denoncim.

**80.4.2** Në dispozitivin e vendimit nr. \*\*\*, datë 29.6.2017, nga Gjykata Administrative e Apelit është vendosur dëmshpërblimi me 12 muaj për shkak të vjetërsisë, ndërkohë, në pjesën arsyetuese ky dëmshpërblim përcaktohet në shumën 5.5 paga, sikundër është kërkuar edhe nga paditësi. Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me këtë konstatim.

**80.4.2.1** Në përgjigje, subjekti ka sqaruar se kolegji, pasi ka konstatuar faktin kryesisht ka bërë ndreqjen e gabimit me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.7.2017, në bazë të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile ku ka vendosur: *“Ndreqjen e gabimit të bërë në dispozitivin e vendimit gjyqësor nr. \*\*\*, datë 29.6.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, në vend të “Detyrimin e*

të paditurit Komanda e Forcave Detare Durrës të shpërblejë paditësen A. Ç., për vjetërsinë në punë me 12 muaj page”, duhet “Detyrimin e të paditurit Komanda e Forcave Detare Durrës të shpërblejë paditësen A. Ç., për vjetërsinë në punë me 5.5 paga mujore”.

**80.4.2.2** Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, konstaton se janë bindëse, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika në lidhje me këtë denoncim.

**80.5** Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 24.4.2019, z. Q. V., ankohet se trupi gjykues, ku në përbërje ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit, është mbështetur në një vendim gjykate, i cili rezulton të jetë prishur nga gjykata më e lartë. Nga analizimi i dokumentacionit rezulton se:

- në datën 19.11.2015 Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. \*\*\* ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe rrëzimin e padisë. Në pjesën argumentuese kjo gjykatë shprehet: “*Gjykata e Faktit Vlorë me vendim nr. \*\*\*, datë 9.12.1998, ka vendosur pavlefshmërinë e kontratës së shitjes*”. Në kushtet kur titulli i pronësisë i paraqitur nga paditësi Q. V., është shpallur i pavlefshëm me vendim gjyqësor, atëherë arrihet në përfundimin se kjo kontratë nuk përbën titull pronësie;
- vendimi nr. \*\*\*, ku është bazuar Gjykata Administrative e Apelit në dhënien e vendimit rezulton të jetë prishur në datën 26.4.1999, me vendim nr. \*\*\*, të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe kthimin e çështje për rigjykim;
- në datën 15.9.1999 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur pushimin e çështjes së mësipërme.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet e mësipërme.

**80.5.1** Subjekti sqaroi se ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Referuar natyrës së gjykimit, në dhomë këshillimi proceduralisht shqyrtimi i dosjes dhe përmbledhja e relacionit përkatës është detyrë funksionale e gjyqtarit relator. Në relacionin e hartuar nga gjyqtari relator si dhe nga parashtrimet e fakteve të bëra prej tij në dhomë këshillimi është evidentuar se vendimi nr. \*\*\*, datë 9.12.1998, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është vendim gjyqësor i formës së prerë. Gjatë relatimit të kryer nuk është evidentuar asnjë e dhënë apo shkak i arsyeshem në mënyrë që znj. Alekelina Gazidedja, si anëtare e trupit gjykues, të kishte dyshime për të verifikuar përmbajtjen e akteve të administruara në dosjen gjyqësore. Në këtë kuptim, subjekti, si anëtare e trupit gjykues nuk mund të penalizohet dhe të mbajë përgjegjësi për çështje, të cilat nuk i takojnë anëtarit të trupit gjykues, por gjyqtarit relator.

**80.5.2** Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit nuk justifikojnë faktin se në cilësinë e anëtares së trupit gjykues ka marrë një vendim mbështetur në një vendim të një gjykate, i cili rezulton të jetë i prishur nga gjykata më e lartë. Është e vërtetë që relatori i çështjes ka për detyrim të relatojë faktet dhe rrethanat, por çdo anëtar ka të drejtë të shohë provat, si dhe të konsultohet me dokumentacionin e dosjes. Komisioni vlerëson se nga subjekti nuk është vepruar drejt në këtë rast, pavarësisht justifikimit me pozicionin në trupin gjykues si anëtare dhe jo relatores, si dhe ngarkesës ditore, por këto veprime nuk janë të një përmase të tillë, që të përbëjnë shkak për shkarkimin e subjektit.

**80.6** Me denoncimin nr. \*\*\*, datë 8.4.2019, z. P. P., ankohet ndaj trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, duke pretenduar se prej saj ka shkelje procedurale në dhënien e vendimit. Nga analizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 14.2.2018, rezulton se:

- Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka pranuar padinë e znj. A. P., e cila përfaqësohej nga av. P. P. Ndërkohë, Gjykata Administrative e Apelit në rrëzimin e padisë argumenton se: “*Në interpretim të praktikës gjyqësore të unifikuar në vendimin nr. 03, datë 30.1.2003, të Kolegjeve të Bashkuara, i cili ka përcaktuar se nuk mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor ligjshmëria e dekretit të presidentit në aspektin procedural, nuk legjitimohet si i paditur Presidenti i Republikës që ka nxjerrë dekretin, por Prokurori i Përgjithshëm. Gjykata*

*Administrative e Apelit çmon se dekretet e presidentit janë akte të natyrës juridiko kushtetues.”*

- Vendimi unifikues ku është mbështetur Gjykata Administrative e Apelit rezulton të jetë shfuqizuar me vendimin datë 23.12.2003, të Gjykatës Kushtetuese.

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimin se gjykata është mbështetur në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

**80.6.1** Subjekti sqaroi se në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se arsyetimi i vendimit bëhet nga kryetari i seancës, përveç kur ai del kundër. Arsyetimi në rastin konkret është bërë nga kryetari i seancës. Për sa më sipër, subjekti nuk mund të mbajë përgjegjësi për mënyrën e parashtrimit të fakteve dhe arsyetimin e kryetarit të seancës, sigurisht që do të ishte ideale të lexoheshin edhe arsyetimet e kolegëve para se të firmosen, por kjo është e pamundur efektivisht me gjithë ngarkesën e madhe në punë.

**80.6.2** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nuk justifikojnë faktin se gjykata është mbështetur në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Në vlerësim të fakteve. Komisioni mban në vëmendje pozitën e subjektit si anëtare e trupit gjykues, si dhe ngarkesën e lartë në këtë gjykatë.

**80.7** Komisioni, pasi analizoi të gjitha denoncimet si më lart, vlerëson se në 27 denoncime të shqyrtuara me kujdes nga trupi gjykues, vetëm në dy prej tyre u konstatuan gabime në vlerësimin e bërë nga trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, në përbërje të së cilës ka qenë subjekti me cilësinë e anëtarit. Komisioni, gjithashtu, konstaton se këto gabime kanë të bëjnë me arsyetimin e vendimit, detyrim ky që përmbushet nga relatori i çështjes, në bazë të nenit 308 të Kodit të Procedurës Civile. Në konkluzion të analizës më sipër, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar dhe vlerësoi shpjegimet e provat e paraqitura nga subjekti, çmohet se nga subjekti i rivlerësimit nuk evidentohen gabime, që përsëriten në mënyrë të vazhdueshme edhe në praktika të ndryshme. Këto gabime nuk përmbajnë shkelje serioze, si dhe nuk mund të klasifikohen si mangësi profesionale.

#### ❖ Në lidhje me rezultatet e hetimit shtesë

**81.** Në datën 9.1.2020, në Komision u administrua një denoncim anonim, i protokolluar me nr. \*\*\* prot., në të cilin pretendohet se:

- subjekti kishte gjykuar çështje ku palë ka qenë shoqëria “\*\*\*\*”, duke qenë në kushtet e konfliktit të interesit për sa kohë ishte aksionere e kësaj shoqërie;
- në dy raste subjekti kishte gjykuar të njëjtën çështje si në shkallë të parë ashtu edhe në apel.

Komisioni kreu një hetim<sup>52</sup> të thelluar në lidhje me këtë denoncim, nga ku rezultoi se:

**82.** Subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore e çështjes në dy gjykime<sup>53</sup> në Gjykatën Administrative të Apelit, ku si palë ka qenë shoqëria “\*\*\*\*”. Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për faktin se ka gjykuar çështje të kësaj shoqërie, duke qenë njëkohësisht edhe aksionere e saj.

**82.1** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti shpjegoi se: *“Sikundër ka rezultuar në hetimin administrativ, aksionet janë në vlerë shumë të vogla dhe tërësisht të papërfillshme, 0.000333,% si dhe nuk ka rezultuar që gjatë kohës që unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarës, familja ime të ketë marrë ndonjë përfitim nga këto aksione, pasi shoqëria ‘\*\*\*’ nuk ka shpërndarë asnjë dividend. Nuk rezulton që në çështjet që kam gjykuar me shoqërinë ‘\*\*\*’ të plotësohet ndonjë*

<sup>52</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2020, drejtuar Gjykatës së Apelit Administrativ; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020; shkresë nr. \*\*\*, datë 22.1.2020, drejtuar Gjykatës së Lartë.

<sup>53</sup> Nr. i çështjes \*\*\*, data e regjistrimit 15.9.2014 dhe nr. i çështjes \*\*\*, datë regjistrimi 17.11.2014.

*prej kushteve të parashikuara në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile, tek i cili të referon ligji nr. 9367, date 7.4.2005, i ndryshuar. As unë dhe as bashkëshorti nuk kanë mbajtur detyrën e kujdestarit, punëdhënësit, administratorit apo ndonjë detyrë tjetër pranë shoqërisë ‘\*\*\*’, në mënyrë që të ishte në kushtet e papajtueshmërisë së parashikuar nga Kodi i Procedurës Civile, nuk ka pasur interes ne çështjet objekt gjykimi, për pasojë nuk plotësohen kushtet e kërkuara nga ligjet e sipërcituara”.*

**82.2** Komisioni, pasi analizoi përgjigjet e subjektit dhe provat e dorëzuar prej saj konstaton se:

i) Në datën 29.9.2016, me vendim nr. \*\*\*, Gjykata Administrative e Apelit ka gjykuar çështjen me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a., dhe subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore e kësaj çështjeje. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë<sup>54</sup> dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

ii) Në datën 18.2.2016, me vendim nr. \*\*\*, Gjykata Administrative e Apelit ka gjykuar çështjen me palë paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.a. dhe subjekti i rivlerësimit ka qenë relatore e kësaj çështjeje. Në përfundim të gjykimit, gjykata ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila kishte vendosur pushimin e gjykimit.

**82.2.1** Bazuar në faktet e mësipërme, si dhe duke marrë në konsideratë rezultatet e hetimit në lidhje me aksionet që ka pasur në pronësi subjekti dhe familjarët e saj në shoqërinë “\*\*\*\*” rezulton se subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, por bazuar në dy vendimet objekt gjykimi nuk rezulton që të ketë favorizuar këtë shoqëri, si dhe duke marrë në konsideratë faktin që së bashku me familjarët e saj kanë pasur në pronësi aksione në vlerë të papërfillshme, si dhe nuk kanë përfituar asnjëherë dividend, ky konflikt interesi në dukje nuk përbën shkak për ta klasifikuar sipas nenit 65/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk kanë ardhur pasoja për palët.

**82.2.2** Në përfundim, Komisioni duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit në dukje, pasi ka gjykuar çështje ku si palë është paraqitur \*\*\*, shoqëri në të cilën ajo dhe familjarët e saj kanë pasur aksione në vlera të vogla vlerëson se znj. Alkelina Gazidedja ka kryer shkelje që lidhen me etikën e magjistratit në punë, që nuk e bëjnë atë të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, dy vendimet e mësipërme duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore nga pikëpamja e etikës në punë.

### **Në lidhje me dy vendimet e Gjykatës së Lartë**

**83.** Në vendimin nr. \*\*\*, datë 6.7.2016, të Gjykatës së Lartë konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në vendimmarrjen në Gjykatën Administrative të Apelit, në një kohë që, për të njëjtën çështje, me palë dhe objekt të njëjtë ka dhënë vendimin nr. \*\*\*, datë 14.9.2009, në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, duke pranuar pjesërisht padinë e paditësit.

**83.1** Komisioni administroi dosjen gjyqësore që i përket këtij vendimi. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit u konstatua se dosja gjyqësore, që i përkiste vendimit nr. \*\*\*, datë 14.9.2009, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit nuk ishte pjesë e dosjes gjyqësore të çështjes, që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 2.4.2014, pavarësisht faktit se ishte e përfshirë në inventarin e dosjet gjyqësore nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\*. Në lidhje me këtë konstatim iu kërkua informacion<sup>55</sup> i mëtejshëm Gjykatës Administrative të Apelit. Në përgjigjen<sup>56</sup> e saj kjo gjykatë sqaroi se nga verifikimi i regjistrave të regjistrimit manual të dosjeve gjyqësore në Gjykatën Administrative të Apelit, respektivisht në vitin 2014 dhe 2016 nuk rezulton të ketë qenë i depozituar fashikulli me nr. \*\*\*, vendim datë 14.9.2009.

<sup>54</sup> Gjykata kishte vendosur pranimin e padisë.

<sup>55</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.1.2020.

<sup>56</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.1.2020.

### **83.2** Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, prapësoi:

Në rekursin e ushtruar ndaj këtij vendimi të Gjykatës Administrative të Apelit, pala paditëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i ka bashkëngjitur rekursit edhe vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 14.9.2009, i cili nuk është ai vendim që ka shqyrtuar Gjykata Administrative e Apelit, anëtare e së cilës ka qenë. Në asnjë moment nuk ka shkelur parimin e gjykimit nga një gjykatë e paanshme, pasi në dosjen gjyqësore të gjykuar në Gjykatën Administrative të Apelit, ky vendim nuk ka qenë i administruar në asnjë prej fashikujve gjyqësorë dhe është marrë në shqyrtim vendimi nr. \*\*\*, datë 28.6.2013, të dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndodhur në këto kushte, subjekti nuk kishte asnjë mundësi të dinte se këtë çështje me këto palë në vitin 2009 e kishte gjykuar një herë, me qëllim që të jepte dorëheqjen nga gjykimi i kësaj çështjeje në Gjykatën Administrative të Apelit në bazë të neneve 72 dhe 73 të Kodit të Procedurës Civile. Këtë çështje e ka pasur në shqyrtim në kohën që ka qenë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe është shprehur me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.9.2009, vendim i cili është prishur dhe kthyer për rigjykim nga Gjykata e Apelit me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.9.2010, në rigjykim Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar me vendim pushimi nr. \*\*\*, datë 5.12.2011 për mosparaqitje të palës paditëse. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.7.2012. Pas pushimit të gjykimit, pala paditëse e ka ngritur sërish këtë padi në datën 17.7.2012, duke kërkuar edhe rivendosjen në afat, e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.11.2012, për rivendosjen në afat të padisë, duke pakësuar pala paditëse objektin e padisë për kundërshtimin e aktit. Më pas, në datën 16.11.2012, paditësi ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, padinë për kundërshtimin e aktit, në përfundim të të cilit gjykata me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2013 ka vendosur rrëzimin e padisë. Ndaj këtij vendimi nr. \*\*\*, datë 28.6.2013 ka ushtruar ankim paditësi. Kjo çështje është marrë në shqyrtim nga një trup gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit në përbërjen e të cilit, me cilësinë e anëtares ka qenë edhe subjekti, e cila sqaron se gjykata është shprehur vetëm për vlefshmërinë e anës formale të ankimit, duke konstatuar se ankimit i mungon vula e shoqërisë, duke disponuar me mospranim ankimi.

Në gjykimin e kryer në Dhomën e Këshillimit në Gjykatën e Apelit Administrativ, nuk është relatuar fakti që subjekti ka shqyrtuar më parë këtë çështje, pasi në dosjen gjyqësore objekt gjykimi nuk është administruar asnjë lloj dokumenti shkresor, i cili të provonte faktin se e kishte gjykuar këtë çështje në një shkallë tjetër gjykimi. Gjithashtu, asnjëra nga palët ndërgjyqëse në këtë gjykim, nuk e ka ngritur ndonjëherë këtë çështje edhe pse duhet të ishin në dijeni të këtij fakti, për shkak se kishin qenë pjesëmarrëse në gjykimin e parë të kryer me të njëjtat palë ndërgjyqëse dhe të njëjtin objekt. Subjekti deklaroi se ka qenë anëtare e trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka vendosur apo shqyrtuar mbi një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë, në të cilën nuk ka qenë gjyqtare.

### **83.3** Komisioni, pasi analizoi dosjen gjyqësore të administruar konstaton se:

- Subjekti ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë padinë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., duke pranuar pjesërisht padinë me vendim nr. \*\*\*, datë 14.9.2009.
- Vendimi nr. \*\*\*, datë 14.9.2009 është prishur nga Gjykata e Apelit dhe është rikthyer për rigjykim.
- Në rigjykim, me një trup gjykues tjetër, Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka disponuar me vendim pushimi nr. \*\*\*, datë 5.12.2011, për mosparaqitje të palës paditëse.
- Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.7.2012.
- Në datën 17.7.2012 pala paditëse “\*\*\*\*” sh.p.k. e ka ngritur sërish padinë, duke kërkuar edhe rivendosjen në afat.

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.11.2012 ka vendosur për rivendosjen në afat të padisë.
- Në datën 16.11.2012 paditësi ka paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, padinë për kundërshtimin e aktit, në përfundim të të cilit gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2013, ka vendosur rrëzimin e padisë. Ndaj këtij vendimi nr. \*\*\*, datë 28.6.2013 ka ushtruar ankim paditësi.
- Gjykata Administrative e Apelit me vendim nr. \*\*\*, datë 2.4.2014 ka vendosur mospranimin e ankimit të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sepse nuk plotëson kushtet ligjore të pranueshmërisë për shqyrtim, pasi ankimi nuk përmban vulën e shoqërisë. Në këtë gjykim subjekti ka qenë anëtare e trupit gjykues.

Nga hetimi ka rezultuar se dosja e vendimit nr. \*\*\*, datë 14.9.2009, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (ku subjekti ishte gjyqtare e vetme) nuk është pjesë e fashikujve të vendimit nr. \*\*\*, datë 28.6.2013 të kësaj gjykate, për të cilën edhe është ankimuar shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. Kjo gjë konfirmohet edhe nga korrespondenca e Komisionit me Gjykatën Administrative të Apelit. Në këto kushte, Komisioni konkludon se trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, në përbërje të të cilit ishte subjekti i rivlerësimit, ka gjykuar një vendim të shpallur nga një gjyqtar tjetër, i ndryshëm nga subjekti. Nisur nga fakti se: (i) vendimi i shpallur nga subjekti si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk ishte pjesë e fashikullit në gjykimin administrativ të apelit; (ii) nga koha e gjatë që nga gjykimi i parë në vitin 2009 e deri në gjykimin në apel në vitin 2014; (iii) në Gjykatën Administrative të Apelit nuk është gjykuar në themel çështja, por vetëm për anën formale të padisë; (iv) subjekti ishte anëtare e trupit gjykues dhe jo relatore e çështjes, Komisioni vlerëson se subjekti ka pasur mundësi të ishte në kushtet e padijes se kishte gjykuar më parë çështjen me palë “\*\*\*\*” sh.p.k.

Bazuar në rrethanat e mësipërme, duke marrë në konsideratë edhe vendimin nr. \*\*\*, datë 11.3.2008, të Gjykatës Kushtetuese,<sup>57</sup> Komisioni çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4, nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ky vendim duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

**84.** Në lidhje me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, të Gjykatës së Lartë konstatohet se subjekti i rivlerësimit, anëtare e trupit gjykues në Gjykatën Administrative të Apelit, ka shqyrtuar të njëjtën kërkesëpadi kur ka qenë pjesë e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Në datën 22.1.2020 iu dërgua shkresa nr. \*\*\* prot., Gjykatës së Lartë për të administruar dosjen e plotë të çështjes që i përket vendimit nr. \*\*\*, datë 4.2.2014, me palë paditëse Prefekti i Qarkut Tiranë. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.1.2020, Gjykata e Lartë na vuri në dispozicion dokumentacionin e kërkuar.

**84.1** Nga hetimi rezultoi se në dosjen gjyqësore gjendet:

- vendim i subjektit të rivlerësimit për caktimin e seancës përgatitore datë 19.3.2010;
- procesverbal veprime përgatitore datë 14.4.2010, të kryera nga subjekti;
- shënim datë 29.4.2010, nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit komunikon se bëhet inkompetente për gjykimin e çështjes, pasi është caktuar në seksionin penal.

<sup>57</sup> Gjykata shprehet: “Në dosjen gjyqësore Gjykata Kushtetuese konstaton se gjyqtarja e pretenduar ka marrë pjesë në përbërjen e trupit gjykues në Dhomën e Këshillimit në Gjykatën e Lartë, ku është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuësve për mungesë të shkaqeve ligjore të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile. Në Gjykatën e Apelit ajo ka marrë pjesë në gjykimin e datës 3.10.2002, kur është pranuar ankesa e kërkuësve kundër vendimit të gjykatës së rrethit dhe për mangësi procedurale është prishur ky vendim e çështja është dërguar për rigjykim në atë gjykatë. Në gjykimin nga Gjykata e Apelit, kjo gjyqtare nuk ka qenë në përbërje të trupit gjykues. Duke u nisur nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se nuk është cenuar standardi kushtetues i paanësisë së gjykatës”.

**84.2** Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka pretenduar se pjesëmarrja e saj në shqyrtimin e kësaj çështjeje në Gjykatën e Apelit Administrativ Tiranë, nuk ka qenë e papajtueshme me asnjë nga rastet që ka parashikuar ligjvënësi në nenin 72 të Kodit të Procedurës Civile dhe se veprimet e kryera mbi këtë çështje nuk kanë asnjë pasojë. Referuar të dhënave që janë të administruar në këtë dosje gjyqësore, ka rezultuar e provuar se kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 17.3.2010 dhe është caktuar me short për t'u shqyrtuar prej saj, si gjyqtare relatores. Në datën 14.4.2010 është kryer seanca përgatitore dhe seanca gjyqësore është caktuar për në datën 13.5.2010. Në datën 19.4.2010 është transferuar si gjyqtare në seksionin penal të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për rrjedhojë, me këtë dosje nuk është kryer më asnjë lloj veprimi procedural nga znj. Alkelina Gazidedja si gjyqtare. Në fazën e gjykimit që e ka marrë në shqyrtim këtë çështje, subjekti nuk ka dhënë asnjë lloj mendimi për themelin e gjykimit, në mënyrë që të konsiderohej si e papajtueshme për të marrë pjesë për gjykimin e saj në një shkallë apo fazë tjetër gjykimi, parashikuar nga pika 4, e nenit 72, të Kodit të Procedurës Civile.

**84.3** Komisioni, pas shqyrtimit të dosjes gjyqësore, konstaton se subjekti ka zhvilluar vetëm një seancë përgatitore në datën 14.4.2010, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në lidhje me çështjen me palë paditëse Prefektin e Qarkut Tiranë dhe palë të paditur znj. P. D., dhe të tjerë.

Subjekti, në datën 19.4.2010, është transferuar në seksionin penal duke mos vijuar me tej gjykimin e kësaj çështjeje. Trupi gjykues i Gjykatës Administrative të Apelit, në përbërje të të cilit, me cilësinë e anëtares ka qenë edhe subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2014, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe pranimin e padisë së paditësit Prefekti i Qarkut Tiranë. Nga shqyrtimi i materialeve të dosjes, rezulton se subjekti, në seancën përgatitore të zhvilluar më 14.4.2010, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka bërë këto veprime<sup>58</sup>:

- ka çelur seancën përgatitore;
- ka verifikuar prezencën e palëve;
- ka vendosur pranimin e kërkesës së paditësit për shtyrjen e seancës përgatitore në datën 13.5.2010.

Nisur nga çfarë rezulton në dosjen gjyqësore, konstatohet se subjekti nuk ka dhënë këshilla apo nuk ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim, si dhe nuk ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në themel. Në këto kushte çmohet se sjellja e subjektit nuk përfshihet në rastet për përjashtimin e gjyqtarit, sipas parashikimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

Pasi analizoi kushtet dhe rrethanat, veprimet e subjektit, si dhe pasojat e ardhura, Komisioni çmon se nuk jemi përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ky vendim duhet të përcillet pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**85.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGj-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale, apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

**86.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

---

<sup>58</sup> Shihni procesverbalin e veprimeve përgatitore datë 14.4.2010, në dosjen gjyqësore.

**87.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

**88.** Në lidhje me shkeljet e kryera nga subjekti në katër vendimet e cituara më lart, Komisioni vlerëson se referuar vendimit nr. 2 /2017, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “*Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*”, nuk i çmon këto shkelje si shkak për vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit, pasi nuk ndikojnë në aftësitë profesionale të subjektit, si dhe nuk përbëjnë shkak për ta konsideruar të papërshtatshëm subjektin për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat, por që në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, këto vendime duhet të përcillen pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore.

### **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konstaton se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në Dhomë Këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe në pikat 1 dhe 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

- 1.** Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Alkelina Gazidedja, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 2.** Në zbatim të pikës 4, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, të përcjellë vendimet e mëposhtme pranë organit kompetent për inspektimin e shkeljeve të mundshme disiplinore, si më poshtë vijon:
  - vendim nr. \*\*\*, datë 7.12.2016, i Gjykatës së Lartë;
  - vendim nr. \*\*\*, datë 6.7.2016, i Gjykatës së Lartë;
  - vendim nr. \*\*\*, datë 29.9.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit;
  - vendim nr. \*\*\*, datë 18.2.2016, i Gjykatës Administrative të Apelit.
- 3.** Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
- 4.** Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.



Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 10.7.2020

**ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela ZHEGU**  
**Kryesuese**

**Firdes SHULI**  
**Anëtare**

**Genta Tafa (BUNGO)**  
**Relatore**

*Sekretare gjyqësore*  
*Orjanda Liçi*